FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 241

Tiranë – E hënë, 9 nëntor 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 834, datë 5.11.2026	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Portual Durrës, të disa pasurive të paluajtshme, ndodhur në zonën kadastrale 8517, Durrës, dhe për disa shtesa në vendimin nr. 586, datë 10.9.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listave të inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat u kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të sistemit të transportit detar dhe ajror", të ndryshuar.....	24643
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 836, datë 5.11.2026	Për një ndryshim në vendimin nr. 805, datë 28.12.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e statusit, mënyrave të pjesëmarrjes dhe masës së dietës ditore për vështirësi shërbimi të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në *Abyei* (UNISFA)"	24647
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 837, data 5.11.2026	Për miratimin e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat, përcaktimin e shpërblimit të veçantë për punonjësit që hartojnë studime fizibiliteti, si dhe përcaktimin e procedurave për nivelin e tarifave për shërbimet e ofruara prej saj.....	24647
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 838, datë 5.11.2026	Për miratimin e vendimit nr. 4/2024, të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, "Për parandalimin e bllokimit gjeografik të pajustifikuar".....	24653
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 839, datë 5.11.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 221, datë 28.3.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik për etiketimin e produkteve të qelqit kristal".....	24658
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 840, datë 5.11.2026	Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës në kushtet e situatës së veçantë në tregun hidrokarbur.....	24659

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 841, datë 5.11.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 278, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti 'Sistemim rrugësh, blloku 'Përroi i Çaprazit', Pogradec"'	24660
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 842, datë 5.11.2026	Për përcaktimin e kategorive të strukturave akomoduese.....	24661
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 843, datë 5.11.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 730, datë 13.12.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme e zonave arkeologjike 'A' dhe 'B' të qytetit të Sarandës, 'Kalasë së Lëkurësit' e 'Manastirit të 40 Shenjtorëve' dhe miratimin e zonimit e të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre".....	24664
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 844, datë 5.11.2026	Për miratimin e masës së mbështetjes financiare për kujdesin alternativ në familje, si dhe të pagesës për kujdesin alternativ profesional.....	24666
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 845, datë 5.11.2026	Për një ndryshim në vendimin nr. 78, datë 7.2.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë", të ndryshuar.....	24667
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 846, datë 5.11.2026	Për rishpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve buxhetore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në buxhetin e miratuar për vitin 2026.....	24667
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 847, datë 5.11.2026	Për kushtet e tjera dhe procedurat për miratimin e trupave të kontrollit dhe njoftimin e aktivitetit nga trupat e kontrollit, që veprojnë në Shqipëri sipas standardeve të tjera për prodhimin organik.....	24667
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë nr. 102 (61-2026-3159), datë 20.7.2026	Plotësimi i vendimit nr. 293, datë 23.6.2026, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.....	24675

VENDIM
Nr. 834, datë 5.11.2026

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, PËR AUTORITETIN PORTUAL DURRËS, TË DISA PASURIVE TË PALUAJTSHME, NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8517, DURRËS, DHE PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 586, DATË 10.9.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË INVENTARËVE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT U KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHOQËRIVE ANONIME DHE NDËRMARRJEVE TË SISTEMIT TË TRANSPORTIT DETAR DHE AJROR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Portual Durrës, të disa pasurive të paluajtshme, ndodhur në zonën kadastrale 8517, Durrës, sipas formularit, 1 (një) fletë, dhe hartave kadastrale të pasurive, 3 (tre) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për ushtrimin e veprimtarisë sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.

2. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohen listës së inventarit të pronave, bashkëlidhur vendimit nr. 586, datë 10.9.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listave të inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat u kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të sistemit të transportit detar dhe ajror", të ndryshuar.

3. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit Portual Durrës u ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit apo tjetërsimi i pasurisë së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Portual Durrës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror: Autoriteti Portual Durrës

Bashkia / Komuna: Durrës

Fusha e përdorimit të Pronës: Për realizimin e projektit të portit të ri tregtar të integruar të Durrësit në Porto Romano (përdorimi i propozuar).

Identifikoi: Soti Nasto
Përgjegjës, Njësia e Administrimit të Pronave,
Supervizoi: Rafaelo Rexho
Drejtor, Drejtoria e Zhvillimit të Infrastrukturës
Aprovoi: Liburn Aliu
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

A				B				C		
Nr. Rend.	Zona Kadastrale & Indeksi i Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndërtesë (m²)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8517 K-34-87-(239-A)	19/9	Arë	Pasuri e llojit arë Bashkia Durrës	4 500	0	Përdorimi faktik: Veprimtari Portuale	MIE	AUTORITETI PORTUAL DURRES	
2	8517 K-34-87-(239-A)	20/4	Arë	Pasuri e llojit arë Bashkia Durrës	6 500	0	Përdorimi faktik: Veprimtari Portuale	MIE	AUTORITETI PORTUAL DURRES	Pronësi: Shtet. Pasuri e përmirësuar / përditësuar me ref. 00011450.
3	8517 K-34-87-(239-A)	20/5	Arë	Pasuri e llojit arë Bashkia Durrës	6 500	0	Përdorimi faktik: Veprimtari Portuale	MIE	AUTORITETI PORTUAL DURRES	Pronësi: Shtet. Pasuri e përmirësuar / përditësuar me ref. 00011451.


Shënim: Sipërfaqja e përgjithshme e tri pasurive është 17 500 m². Të dhënat kadastrale janë marrë nga kartelat e datës 06.08.2026. Për këto pasuri ka përfunduar procesi i përmirësim azhornimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE:	8517	KODI UNIK:	8517032089
NUMRI PASURISË:	19/9	INDEKSI HARTËS:	K-34-87-(239-A)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 2500

DREJTORI
Elvis Pengili

Alban Haxhillari — Digitally signed by: Alban Haxhillari Date: 2026.08.19 10:31:33 +02'00'
Kristi Prifti — Digitally signed by: Kristi Prifti Date: 2026.08.19 11:10:52 +02'00'
Elvis Pengili — Digitally signed by: Elvis Pengili Date: 2026.08.19 11:33:32 +02'00'

Data e leshimit 8/19/2026

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore DURRËS-KAVAJË-KRUJË
Date:2026/08/19 10:31:17 +02'00'
J618115361.20260819103110951 4014

SHPJEGUES
PARCELA
NDËRTESA


Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE:	8517	KODI UNIK:	8517035042
NUMRI PASURISË:	20/4	INDEKSI HARTËS:	K-34-87-(239-A)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 2500

DREJTORI
Elvis Pengili

Alban Haxhillari — Digitally signed by: Alban Haxhillari — Date: 2026.08.19 10:53:46 +02'00'
Kristi Prifti — Digitally signed by: Kristi Prifti — Date: 2026.08.19 11:13:31 +02'00'
Elvis Pengili — Digitally signed by: Elvis Pengili — Date: 2026.08.19 11:36:00 +02'00'

8/19/2026

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore DURRËS-KAVAJË-KRUJË
Date:2026/08/19 10:35:28 +02'00'
J61811536L20260819103521791l4014

SHPJEGUES
PARCELA
NDËRTESA


Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE:	8517	KODI UNIK:	8517035043
NUMRI PASURISË:	20/5	INDEKSI HARTËS:	K-34-87-(239-A)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 2500

DREJTORI
Elvis Pengili

Alban Haxhillari — Digitally signed by: Alban Haxhillari Date: 2026.08.19 11:03:08 +02'00'
Kristi Prifti — Digitally signed by: Kristi Prifti Date: 2026.08.19 11:13:55 +02'00'
Elvis Pengili — Digitally signed by: Elvis Pengili Date: 2026.08.19 11:36:30 +02'00'

8/19/2026

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore DURRËS-KAVAJË-KRUJË
Date:2026/08/19 10:36:25 +02'00'
J61811536L20260819103618851014

SHPJEGUES
PARCELA
NDËRTESA

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

VENDIM
Nr. 836, datë 5.11.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 805, DATË 28.12.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT, MËNYRAVE TË PJESËMARRJES DHE MASËS SË DIETËS DITORE PËR VËSHTIRËSI SHËRBIMI TË PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MISIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA NË *ABYEI* (UNISFA)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikave 2 e 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit", si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të shkronjës "b", të nenit 3, të aktit normativ nr. 4, datë 20.6.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në *Abyei* (UNISFA)", miratuar me ligjin nr. 59/2023, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 805, datë 28.12.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e statusit, mënyrave të pjesëmarrjes dhe masës së dietës ditore për vështirësi shërbimi të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në *Abyei* (UNISFA)", togfjalëshi "... prej 3 (tre) vjetësh ..." zëvendësohet me "... deri më 28.12.2029 ...".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 837, data 5.11.2026

PËR MIRATIMIN E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KONCESIONEVE DHE PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT, PËRCAKTIMIN E SHPËRBLIMIT TË VEÇANTË PËR PUNONJËSIT QË HARTOJNË STUDIME FIZIBILITETI, SI DHE PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR NIVELIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA PREJ SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 13, të ligjit nr. 88/2025, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij vendimi është:

a) miratimi i organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat (në tekstin në vijim Agjencia);

b) përcaktimi i shpërblimit të veçantë për punonjësit e Agjencisë që hartojnë studime fizibiliteti;

c) miratimi i procedurave për përcaktimin e tarifave për shërbimet që do të ofrohen nga Agjencia.

Neni 2
Statusi, selia dhe buxheti i ATRAKO-s

Agjencia është një institucion publik, buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë. Buxheti i Agjencisë financohet nga buxheti i shtetit, si dhe nga të ardhurat që sigurohen nga shërbimet që ofron dhe miratohet si zë më vete në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

Neni 3
Misioni i Agjencisë

Misioni i Agjencisë është të kontribuojë në zhvillimin e koncesioneve dhe partneriteteve publike private, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet evropiane, nëpërmjet rregullimit dhe mbikëqyrjes së praktikave përkatëse, ofrimit të mbështetjes teknike dhe asistencës për autoritetet/ entet kontraktuese, si dhe ushtrimit të kompetencave, të përcaktuara në ligjin nr. 88/2025.

KAPITULLI II
PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KONCESIONEVE DHE PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

Neni 4
Përgjegjësitë funksionale

1. Në zbatim të kompetencave të përcaktuara në nenin 13 dhe të marrëdhënieve me autoritetet/entet kontraktuese, të parashikuara në nenin 14, të ligjit nr. 88/2025, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", Agjencia organizon punën, për:

a) ofrimin e mbështetjes teknike dhe asistencës për autoritetet/entet kontraktuese për identifikimin e projekteve të mundshme të koncesionit/ partneritetit publik privat, si dhe mbështetje metodologjike, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 88/2025;

b) hartimin, zhvillimin dhe përditësimin e dokumenteve standarde të koncesionit/partneritetit publik privat;

c) analizimin e praktikave në fushën e koncesioneve/partneritetit publik privat dhe përgatitjen e propozimeve për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe metodologjik, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 88/2025, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat".

2. Për organizimin e ushtrimit të kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 88/2025, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", Agjencia kryen veprimtaritë e mëposhtme:

a) harton studimet e fizibilitetit për projektet e institucioneve qendrore dhe enteve në varësi të tyre;

b) harton studimet e fizibilitetit për projektet e institucioneve të vetëqeverisjes vendore dhe enteve të përcaktuara në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 88/2025, kundrejt pagesës së një tarife të posaçme dhe në varësi të disponueshmërisë;

c) mbikëqyr veprimtarinë e njësisë së zbatimit të kontratës, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me detyrimet e përcaktuara në nenin 60, të ligjit nr. 88/2025 dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij;

ç) monitoron përputhshmërinë me standardet dhe procedurat e miratuara për koncesionet/PPP-të dhe rekomandon masa për përmirësimin e tyre;

d) ofron trajnime dhe asistencë teknike për autoritetet kontraktuese, me qëllim rritjen e kapaciteteve institucionale në këtë fushë;

dh) mbledh, përpunon dhe analizon të dhënat dhe informacionin mbi koncesionet/partneritetet publike private që i raportohen, në përputhje me ligjin nr. 88/2025 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

e) bashkëpunon me institucionet kombëtare e ndërkombëtare dhe organizatat financiare për të siguruar standardizimin me praktikat më të mira evropiane, shkëmbimin e eksperiencës dhe zhvillimin e kapaciteteve;

ë) bashkëpunon me Agjencinë e Prokurimit Publik për publikimin e dokumenteve standarde të tenderit;

f) krijon dhe mban Regjistrin e Koncesioneve/ Partneriteteve Publike Private, në përputhje me nenin 17, të ligjit nr. 88/2025, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

3. Përcaktimet e shkronjave "a" dhe "b", të pikës 2, të këtij neni, zbatohen pa cenuar rastet e parashikuara në pikën 3, të nenit 20, të ligjit nr. 88/2025, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", kur studimi i fizibilitetit përgatitet nga vetë autoriteti ose enti kontraktues. Në këto raste, Agjencia ushtron funksionet e saj të ekspertizës së specializuar dhe/ose oponencës, në përputhje me kërkesat e ligjit.

4. Në ushtrimin e funksioneve që lidhen me identifikimin e projekteve të mundshme të koncesionit/partneritetit publik privat dhe përgatitjen e studimeve të fizibilitetit, Agjencia vepron, në përputhje me pikat 4–6, të nenit 23, të ligjit nr. 88/2025, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat". Për projektet që shoqërohen me investime, të cilat mund të kërkojnë angazhimin e fondeve të buxhetit të shtetit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, aktualisht ose në të ardhmen, dhe kur vlera e plotë e investimit është mbi vlerat kufi të miratuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat, identifikimi dhe vlerësimi i nevojës për projekt kryhen në përputhje me procedurat e menaxhimit të investimeve publike, pa paragjykuar formën e financimit apo mënyrën e zbatimit të projektit. Për projektet nën kufijtë financiarë të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat ndiqen procedurat sipas ligjit nr. 88/2025, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat".

KAPITULLI III
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KONCESIONEVE DHE PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

Neni 5
Shtrirja e aktivitetit dhe struktura organizative

1. Agjencia e shtrin aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

2. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

Neni 6
Fusha e veprimtarisë

Agjencia ushtron veprimtarinë dhe kryen detyrat e saj në fushën e koncesioneve dhe partneritetit publik privat, në përputhje me ligjin nr. 88/2025, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 7
Bashkëpunimi dhe detyrimi për dorëzimin e dokumentacionit

1. Agjencia bashkëpunon me autoritetet/entet kontraktuese, në përputhje me nenin 14, të ligjit nr. 88/2025, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat".

2. Autoritetet/entet kontraktuese i paraqesin Agjencisë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, një kopje të kontratës, së bashku me dokumentet e tenderit dhe shtojcat/anekset që janë pjesë e saj. Çdo shtojcë ose aneks i nënshkruar pas lidhjes së kontratës i paraqitet Agjencisë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të tij.

3. Në rast të mosparaqitjes së informacionit ose dokumentacionit të kërkuar, Agjencia vepron në përputhje me kompetencat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 8
Rregullorja e brendshme

Rregullorja, që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Agjencisë, miratohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, me propozimin e kryetarit të Agjencisë.

Neni 9
Drejtimi i ATRAKO-S

1. Agjencia drejtohet nga kryetari, i cili organizon dhe drejton të gjitha aktivitetet e saj dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me palët e treta.

2. Kryetari i Agjencisë është përgjegjës ndaj ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ka detyrat e mëposhtme:

a) përcakton objektivat dhe detyrat e njësive organizative brenda Agjencisë;

b) koordinon punën midis njësive organizative brenda Agjencisë;

c) nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshme, me qëllim marrjen e masave dhe përmbushjen me efikasitet të detyrave dhe objektivave të Agjencisë, si dhe disiplinimin e veprimtarisë së saj.

Neni 10
Marrëdhëniet e punësimit

1. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Agjencisë rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil.

2. Marrëdhëniet e punës së kryetarit dhe të punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

Neni 11
Shpërblimi i veçantë për punonjësit e Agjencisë

Për çdo studim fizibiliteti të përfunduar dhe të dorëzuar zyrtarisht, punonjësi që ka marrë pjesë drejtpërdrejt në hartimin e tij mund të përfitojë shpërblim deri në masën e një page mujore bruto, sipas pozicionit të punës në muajin e dorëzimit të studimit, por, në çdo rast, jo më shumë se tri studime fizibiliteti në vit. Masa konkrete e shpërblimit përcaktohet në bazë të kontributit të dokumentuar të punonjësit dhe fondeve në dispozicion, duke respektuar kufirin e përgjithshëm vjetor.

Neni 12
Emërimi dhe kriteret e përzgjedhjes së kryetarit

1. Kryetari i Agjencisë emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për ekonominë.

2. Kryetari i Agjencisë duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë një diplomë "Master i shkencave", të fituar në përfundim të studimeve të ciklit të dytë me 120 (njëqind e njëzet) kredite dhe një kohëzgjatje normale prej 2 (dy) vitesh akademike, ose ekuivalente, sipas legjislacionit për arsimin e lartë në shkencat ekonomike/juridike;

ç) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë profesionale;

d) të dallohet për një karakter të pastër etik dhe moral;

dh) të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;

e) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

ë) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

f) të mos ketë konflikt interesi me detyrën, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

Neni 13
Lirimi nga detyra i kryetarit

Kryetari i Agjencisë lirohet nga detyra, kur:

a) mbush moshën për pension të plotë pleqërie;

b) shpallet i paaftë për punë nga komisioni mjekësor kompetent;

c) është në një situatë konflikti të vazhdueshëm interesi;

ç) jep dorëheqjen nga detyra.

Neni 14
Shkarkimi nga detyra i kryetarit

Kryetari i Agjencisë shkarkohet nga detyra, kur:

a) dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi ose të një vepre penale;

b) konstatohen shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfshirë legjislacionin specifik mbi të cilin Agjencia ushtron aktivitetin e saj;

c) kryen aktivitete që krijojnë konflikt interesi;

ç) gjendet në kushtet e ndalimit të kryerjes së funksioneve publike, sipas legjislacionit mbi integritetin e personave të zgjedhur, të emëruar ose që ushtrojnë funksione publike;

d) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrave të tij/saj;

dh) vërtetohet se ka përgjegjësi për mosarritjen e objektivave të përcaktuar për Agjencinë.

Neni 15
Stema, logoja dhe vula zyrtare

1. Agjencia ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema e Agjencisë përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria e (emri i ministrisë përgjegjëse për ekonominë), Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat", në përputhje me dispozitat e vendimit të Këshillit të Ministrave për

mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

2. Vula e Agjencisë ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI IV
PROCEDURA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KONCESIONEVE DHE PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

Neni 16
Natyra dhe qëllimi i tarifës

1. Agjencia siguron të ardhura nga shërbimet që kryen në dobi të autoriteteve/enteve kontraktuese.

2. Tarifa e shërbimit përbën pagesën për shërbimet konkrete dhe të dokumentuara që Agjencia ofron për një projekt të caktuar, në përputhje me kompetencat e saj ligjore dhe që lidhen me hartimin e studimit të fizibilitetit, dhënien e ekspertizës së specializuar dhe/ose oponencës, asistencën teknike, si dhe përgatitjen ose shqyrtimin teknik e metodologjik të dokumentacionit të projektit.

3. Kur studimi i fizibilitetit përgatitet nga vetë autoriteti ose enti kontraktues, tarifa aplikohet vetëm nëse Agjencia ofron një ose më shumë nga shërbimet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni. Ushtrimi i funksioneve të përgjithshme rregullatore, mbikëqyrëse, raportuese, metodologjike ose i funksionit të krijimit dhe mbajtjes së regjistrit nuk përbën, në vetvete, bazë për aplikimin e tarifës.

Neni 17
Vlera dhe mënyra e pagesës së tarifave

1. Tarifa për shërbimet e ofruara nga Agjencia shpallet në dokumentet e procedurës konkurruese dhe paguhet nga operatori ekonomik i shpallur fitues, përpara nënshkrimit të kontratës me autoritetin/entin kontraktor, në masat e mëposhtme:

a) Për projektet me koncesione/PPP, me një vlerë investimi deri në 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë, tarifa është 700 000 (shtatëqind mijë) lekë;

b) Për projektet me koncesion/PPP, me vlerë investimi mbi 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë deri në 2 100 000 000 (dy miliardë e njëqind milionë) lekë, tarifa është 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë;

c) Për projektet me koncesion/PPP, me vlerë investimi mbi 2 100 000 000 (dy miliardë e njëqind milionë) lekë deri në 7 000 000 000 (shtatë miliardë) lekë, tarifa është 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë;

ç) Për projektet me koncesione/PPP, me një vlerë investimi mbi 7 000 000 000 (shtatë miliardë) lekë, tarifa është 4 200 000 (katër milionë e dyqind mijë) lekë.

2. Tarifat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni lidhen me shërbimet e parashikuara në nenin 16 dhe janë të veçanta nga tarifa e shërbimit për konsulencën e jashtme, e rregulluar në kapitullin V të këtij vendimi, kur plotësohen kushtet për aplikimin e saj.

Neni 18
Trajtimi i të ardhurave dhe auditimi financiar

1. Të ardhurat e përftuara nga tarifat e parashikuara në nenin 17, të këtij vendimi, derdhen në buxhetin e shtetit.

2. Administrata dhe veprimtaria financiare auditohen nga ministria përgjegjëse për ekonominë dhe institucione të tjera të ngarkuara me ligj për auditimin.

KAPITULLI V
TARIFA E SHËRBIMIT PËR KONSULENCËN E JASHTME TË PËRDORUR NË PËRGATITJEN E STUDIMEVE TË FIZIBILITETIT

Neni 19
Natyra dhe pagesa e tarifës së shërbimit

1. Kur Agjencia, në përputhje me shkronjën "d", të pikës 6, të nenit 13, të ligjit nr. 88/2025, angazhon konsulentë të jashtëm në funksion të përgatitjes së një studimi fizibiliteti, kostot faktike dhe të dokumentuara, që lidhen drejtpërdrejt me këtë konsulencë, përfshihen në tarifën e shërbimit të

ofruar nga Agjencia për përgatitjen e studimit të fizibilitetit, për qëllime të pikës 4, të nenit 13, të ligjit nr. 88/2025, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat".

2. Tarifa e shërbimit për konsulencën e jashtme përfshin vetëm kostot faktike dhe të dokumentuara, që lidhen drejtpërdrejt me konsulencën e angazhuar në funksion të përgatitjes së studimit të fizibilitetit dhe mund të përfshijë, sipas rastit:

a) analiza teknike dhe inxhinierike;

b) analiza ekonomike dhe financiare;

c) analiza ligjore dhe rregullatore;

ç) vlerësime mjedisore dhe sociale;

d) shërbime të tjera konsulence dhe asistence teknike që lidhen drejtpërdrejt me përgatitjen e studimit.

3. Kostot e konsulencës së jashtme planifikohen sipas rregullave të menaxhimit buxhetor dhe përballohen, brenda fondeve të miratuara, nga buxheti i Agjencisë.

4. Shuma e tarifës së shërbimit, e përcaktuar mbi bazën e kostove faktike dhe të dokumentuara dhe brenda kufijve maksimalë të përcaktuar në nenin 21 të këtij vendimi, shpallet në dokumentet e procedurës konkurruese dhe paguhet nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat.

5. Shumat e mbledhura nga tarifa e shërbimit, sipas këtij neni, derdhen në buxhetin e shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin buxhetor.

Neni 20

Kufijtë maksimalë të tarifës së shërbimit për konsulencën e jashtme

1. Tarifa e shërbimit për konsulencën e jashtme, e parashikuar në nenin 20 të këtij vendimi, nuk mund të kalojë përqindjet e mëposhtme të vlerës totale të investimit të parashikuar të projektit:

a) Për projekte me vlerë investimi deri në 1 500 000 000 (një miliard e pesëqind milionë) lekë, deri në 1.5%;

b) Për projekte me vlerë investimi prej 1 500 000 001 (një miliard e pesëqind milionë e një) deri në 20 000 000 000 (njëzet miliardë) lekë, deri në 1.0%;

c) Për projekte me vlerë investimi prej 20 000 000 001 (njëzet miliardë e një) deri në 50 000 000 000 (pesëdhjetë miliardë) lekë, deri në 0.75%;

ç) Për projekte me vlerë investimi mbi 50 000 000 000 (pesëdhjetë miliardë) lekë, deri në 0.5%.

2. Përqindjet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, përbëjnë kufijtë maksimalë të tarifës së shërbimit dhe nuk krijojnë një të drejtë automatike për pagesë në këtë masë. Shuma përfundimtare e tarifës përcaktohet në bazë të kostove faktike dhe të dokumentuara dhe, në asnjë rast, nuk mund të tejkalojë kufirin maksimal të zbatueshëm.

KAPITULLI VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 21

Vijimësia e funksionimit

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) do të vijojë funksionimin e saj, deri në fillimin e funksionimit të plotë të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat.

Neni 22

Trajtimi i nëpunësve civilë në rast ristrukturimi

Nëpunësit civilë aktualë të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) trajtohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.

Neni 23

Zbatimi dhe hyrja në fuqi

1. Vendimi nr. 285, datë 10.4.2020, i Këshillit të Ministrave, "Për organizimin, funksionimin si dhe procedurat e niveli i tarifave të shërbimeve që do të ofrohen nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)", i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 88/2025, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat".

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 838, datë 5.11.2026

PËR MIRATIMIN E VENDIMIT NR. 4/2024, TË KOMITETIT TË PËRBASHKËT TË MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS QENDRORE, "PËR PARANDALIMIN E BLLOKIMIT GJEOGRAFIK TË PAJUSTIFIKUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e vendimit nr. 4/2024, të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, "Për parandalimin e bllokimit gjeografik të pajustifikuar", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
I KOMITETIT TË PËRBASHKËT TË MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS QENDRORE

NR. 4/2024
PËR PARANDALIMIN E BLLOKIMIT GJEOGRAFIK TË PAJUSTIFIKUAR
Miratuar në 9 tetor 2024

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objektivat

1. Me këtë vendim, palët angazhohen të parandalojnë bllokimin gjeografik të pajustifikuar dhe forma të tjera diskriminimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, bazuar në palën ku klienti është person fizik ose mbi bazën e vendbanimit, ose vendit të themelimit të tij.

2. Si rrjedhojë, ky vendim synon të harmonizojë kuadrin ligjor, në lidhje me parandalimin e praktikave diskriminuese të pajustifikuara për palët.

Neni 2
Objekti i vendimit

1. Dispozitat e këtij vendimi nuk do të zbatohen vetëm për situata të brendshme, ku të gjithë elementet përkatëse të transaksionit kufizohen brenda një pale të vetme.

2. Ky vendim nuk zbatohet, për:

a) shërbimet joekonomike me interes të përgjithshëm;

b) shërbimet financiare;

c) shërbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike, si dhe pajisjet dhe shërbimet e lidhura me to;

d) shërbimet në fushën e transportit, duke përfshirë shërbimet në port;

e) shërbimet e agjencive të punës së përkohshme;

f) shërbimet e kujdesit shëndetësor nëse ofrohen ose jo nëpërmjet pajisjeve të kujdesit shëndetësor, dhe pavarësisht nga mënyrat në të cilat organizohen dhe financohen në nivel pale ose nëse janë publike apo private;

g) shërbimet audiovizive, duke përfshirë shërbimet kinematografike, pavarësisht nga mënyra e prodhimit, shpërndarjes dhe transmetimit, si dhe transmetimi radiofonik;

h) aktivitetet e lojërave të fatit që përfshijnë vendosjen e një shume me vlerë monetare në lojërat e fatit, duke përfshirë lotaritë, lojërat e fatit në kazino dhe transaksionet e basteve;

i) aktivitetet që janë të lidhura, qoftë edhe herë pas here, me ushtrimin e autoritetit zyrtar;

j) shërbimet sociale, në lidhje me strehimin social, kujdesin për fëmijët dhe mbështetjen e familjeve dhe personave në nevojë të përhershme ose të përkohshme, të cilat ofrohen nga pala, nga ofruesit e autorizuar të palës ose nga organizata bamirëse të njohura si të tilla nga pala;

k) shërbimet private të sigurisë; dhe

l) shërbimet e ofruara nga noterët dhe përmbaruesit, të cilët caktohen me akt zyrtar nga një palë.

3. Ky vendim nuk cenon dhe nuk zbatohet në fushën e tatimeve.

4. Ky vendim nuk ndikon në rregullat e zbatueshme në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave që lidhen me të.

5. Ky vendim zbatohet vetëm ndërmjet palëve.

Neni 3
Përkufizime

1. Për qëllimet e këtij vendimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "**Pala**": një palë në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA);

2. "**Shërbimet e ofruara në mënyrë elektronike**": shërbime, të cilat ofrohen nëpërmjet internetit ose një rrjeti elektronik dhe natyra e të cilave e bën furnizimin e tyre kryesisht të automatizuar dhe që përfshin ndërhyrje minimale njerëzore, dhe të pamundur për t'u siguruar në mungesë të teknologjisë së informacionit;

3. "**Tarifa e këmbimit**": një tarifë e paguar për çdo transaksion në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi (d.m.th., nëpërmjet një pale të tretë) ndërmjet emetuesit dhe blerësit të përfshirë në një transaksion pagese të bazuar në kartë. Kompensimi neto ose shpërblimi tjetër i rënë dakord konsiderohet si pjesë e tarifës së këmbimit; ndërsa:

a) "**kompensim neto**": shuma totale neto e pagesave, rimbursimeve ose stimujve të marra nga një emetues prej skemës së kartës së pagesave, blerësi ose ndonjë ndërmjetës tjetër, në lidhje me transaksionet e pagesave të bazuara në kartë ose aktivitetet e lidhura me to;

i. "**emetues**": një ofrues i shërbimeve të pagesave që lidh kontratë për t'i siguruar një paguesi një instrument pagese, për të filluar dhe përpunuar transaksionet e pagesave të bazuara në kartë të paguesit;

ii. "**blerës**": një ofrues i shërbimeve të pagesave që lidh kontratë me një përfitues për të pranuar dhe përpunuar transaksione pagesash të bazuara në kartë, të cilat rezultojnë në një transferim fondesh tek përfituesi;

iii. "**skemë e pagesave me kartë**": një grup i vetëm rregullash, praktikash, standardesh dhe/ose udhëzimesh zbatimi, për kryerjen e transaksioneve të pagesave të bazuara në kartë dhe që është i ndarë nga çdo infrastrukturë ose sistem pagese që mbështet funksionimin e tij dhe përfshin çdo organ specifik vendimmarrës, organizatë ose subjekt përgjegjës për funksionimin e skemës;

b) "**transaksion pagese i bazuar në kartë**": një shërbim i bazuar në infrastrukturën dhe rregullat e biznesit të skemës së pagesave me kartë, për kryerjen e një transaksioni pagese me anë të çdo karte, pajisjeje ose softueri të telekomunikacionit, teknologjisë së informacionit ose digjitale, nëse kjo rezulton në një transaksion me kartë debiti ose krediti. Transaksionet e pagesave të bazuara në kartë përjashtojnë transaksionet e bazuara në lloje të tjera të shërbimeve të pagesave. Transaksionet e pagesave të bazuara në kartë përjashtojnë transaksionet e bazuara në lloje të tjera të shërbimeve të pagesave;

c) "**transaksion pagese**": një veprim, i iniciuar nga paguesi ose për llogari të tij, ose nga përfituesi i pagesës, për vendosjen, transferimin ose tërheqjen e fondeve, pavarësisht nga ndonjë detyrim tjetër ndërmjet paguesit dhe përfituesit; dhe:

i. "**përfitues**": një person fizik ose juridik, i cili është marrësi i parashikuar i fondeve që kanë qenë objekt i një transaksioni pagese;

ii. "**pagues**": një person fizik ose juridik, i cili është titullar i një llogarie pagesash dhe lejon një urdhërpagesë nga kjo llogari pagese, ose, kur nuk ka llogari pagese, një person fizik ose juridik që jep një urdhërpagesë;

iii. "**urdhërpagesë**": një urdhër nga një pagues ose përfitues për ofruesin e tij të shërbimit të pagesave që kërkon ekzekutimin e një transaksioni pagese;

4. "**Markë pagese**": çdo emër, term, shenjë, simbol material ose numerik, ose kombinim i këtyre elementeve që mund të tregojë nën cilën skemë pagesash me kartë kanë ndodhur transaksionet e pagesave me karta;

5. "**Shërbimi i pagesës**":

a) shërbimet që mundësojnë depozitimin e parave fizike në një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese;

b) shërbimet që mundësojnë tërheqjen e parave fizike nga një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese;

c) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagesash pranë ofruesit të shërbimit të pagesave të përdoruesit ose pranë një ofruesi tjetër të shërbimit të pagesave:

i. ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;

ii. ekzekutimi i transaksioneve të pagesave nëpërmjet një karte pagese ose një pajisjeje të ngjashme;

iii. ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike;

d) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, ku fondet mbulohen nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave:

i. ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;

ii. ekzekutimi i transaksioneve të pagesave nëpërmjet një karte pagese ose një pajisjeje të ngjashme;

iii. ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike;

e) emetimi i instrumenteve të pagesave dhe/ose pranimi i transaksioneve të pagesave;

f) dërgesat e parave;

g) shërbimet e inicimit të pagesave;

h) shërbimet e informacionit të llogarisë;

6. "**Llogari pagese**": një llogari e mbajtur në emër të një ose më shumë përdoruesve të shërbimeve të pagesave që përdoret për kryerjen e transaksioneve të pagesave;

7. "**Instrument pagese**": çdo pajisje e personalizuar dhe/ose një tërësi procedurash të rëna dakord ndërmjet përdoruesit të shërbimit të pagesave dhe ofruesit të shërbimit të pagesave dhe të përdorura me qëllim inicimin e një urdhërpagese;

8. "**Debitim direkt**": një shërbim pagese për debitimin e llogarisë së pagesave të një paguesi, ku një transaksion pagese iniciohet nga përfituesi i pagesës në bazë të pëlqimit të dhënë nga paguesi për përfituesin, për ofruesin e shërbimit të pagesave të përfituesit të pagesës ose për ofruesin e shërbimit të pagesave të vet paguesit;

9. "**Transfertë krediti**": një shërbim pagese për kreditimin e llogarisë së pagesës të një përfituesi me një transaksion pagese ose një seri transaksionesh pagese nga llogaria e pagesës së një paguesi që kryhet nga ofruesi i shërbimit të pagesave që mban llogarinë e pagesave të paguesit, bazuar në një udhëzim të dhënë nga paguesi;

10. "**Konsumator**": çdo person fizik i një pale, i cili vepron për qëllime jashtë fushës së tij/saj të tregtisë, biznesit, të zejes ose profesionit të tij/saj;

11. "**Klient**": një konsumator që është person fizik i një pale, ose ka vendbanimin e tij/saj në një palë, ose një sipërmarrje që ka vendin e saj të themelimit brenda një pale dhe merr një shërbim ose ble një mall ose kërkon ta bëjë këtë, brenda një pale, vetëm me qëllimin e përdorimit fundor;

12. "**Kushtet e përgjithshme të aksesit**": të gjitha termat, kushtet dhe informacionet e tjera, përfshirë çmimet neto të shitjes, të cilat rregullojnë aksesin e klientëve në mallrat ose shërbimet e ofruara për shitje nga një tregtar, të cilat vendosen, zbatohen dhe vihen në dispozicion të publikut të gjerë nga ose në emër të tregtarit dhe që zbatohen në mungesë të një marrëveshjeje të negociuar individualisht ndërmjet tregtarit dhe klientit;

13. "**Mallra**": çdo artikull i luajtshëm i prekshëm, me përjashtim të artikujve të shitur me anë të ekzekutimit ose ndryshe me fuqinë e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative;

14. "**Ndërfaqe *online***": çdo softuer, përfshirë një faqe interneti ose pjesë e saj, si dhe aplikacione, përfshirë aplikacionet celulare, të drejtuara nga ose në emër të një tregtari, i cili shërben për t'u dhënë klientëve akses në mallrat ose shërbimet e tregtarit, me synimin për t'u angazhuar në një transaksion në lidhje me ato mallra ose shërbime;

15. "**Shërbim**": çdo aktivitet ekonomik i vetëpunësuar, normalisht i ofruar kundrejt shpërblimit, për aq sa nuk rregullohet nga dispozitat e lidhura me lirinë e lëvizjes së mallrave, kapitalit dhe personave; në veçanti: aktivitete me karakter industrial; aktivitete me karakter tregtar; aktivitete artizanale dhe aktivitete profesionale;

16. "**Tregtar**" nënkupton çdo person fizik ose çdo person juridik, pavarësisht nëse është në pronësi private apo publike, i cili vepron, nëpërmjet ndonjë personi tjetër në emër ose për llogari të tregtarit, për qëllime të lidhura me tregtinë, biznesin, zejen ose profesionin e tregtarit.

Neni 4
Parimi i mosdiskriminimit

1. Palët sigurojnë që klientët të mos i nënshtrohen kërkesave diskriminuese të bazuara në palën ku klientët janë persona fizikë, ose mbi bazën e vendbanimit ose vendit të themelimit të klientëve.

2. Palët sigurojnë që kushtet e përgjithshme të aksesit në mallra ose shërbime, të cilat vihen në dispozicion të publikut të gjerë nga një tregtar, të mos përmbajnë dispozita diskriminuese në lidhje me palën, klientët e së cilës janë persona fizikë, ose mbi

bazën e vendbanimit ose vendit të themelimit të klientit, por pa përjashtuar mundësinë e parashikimit të dallimeve në kushtet e aksesit, kur këto dallime justifikohen drejtpërdrejt me kritere objektive.

KAPITULLI II
DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 5
Aksesi në ndërfaqet *online*

1. Palët duhet të sigurojnë që tregtarët e kanë të ndaluar:

a) të bllokojnë ose kufizojnë aksesin e klientëve në ndërfaqet *online* të tregtarit, përmes përdorimit të masave ose mjeteve të tjera teknologjike, për qëllime të lidhura me palën, në të cilën klienti është person fizik, ose për shkak të vendbanimit ose vendit të themelimit të klientit në një palë;

b) të ridrejtojnë një klient për arsye që lidhen me palën, në të cilën klienti është person fizik, ose për shkak të vendbanimit ose vendit të themelimit të klientit në një Palë, tek një version i ndërfaqes *online* të tregtarit që është e ndryshme nga ndërfaqja *online* ku klienti kërkoi fillimisht akses, për shkak të paraqitjes së saj, përdorimit të gjuhës ose karakteristikave të tjera që e bëjnë atë specifike për klientët, të cilët janë persona fizikë të një pale të caktuar, ose për klientët me vendbanim të caktuar ose vendthemelimi në një palë, përveç rastit kur klienti ka pranuar në mënyrë të qartë një ridrejtim të tillë.

2. Palët sigurojnë që në rast ridrejtimi me miratimin e qartë të klientit, tregtarët janë të detyruar ta mbajnë lehtësisht të aksesueshëm për atë klient, versionin e ndërfaqes *online* të tregtarit në të cilin klienti fillimisht kërkoi akses.

3. Palët marrin në konsideratë që ndalimet sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk zbatohen kur bllokimi ose kufizimi i aksesit, ose ridrejtimi është i nevojshëm për të garantuar përputhshmërinë me një kërkesë të përcaktuar në ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të një pale në përputhje me CEFTA-n, si dhe me të gjitha vendimet e Komitetit të Përbashkët të miratuara dhe të bazuara në të, ndaj të cilave u nënshtrohen aktivitetet e tregtarit.

4. Në rastet sipas paragrafit 3, palët marrin përsipër të detyrojnë tregtarët që t'u japin klientëve një shpjegim të qartë dhe specifik në lidhje me arsyet përse bllokimi ose kufizimi i aksesit, ose ridrejtimi është i nevojshëm për të garantuar një përputhshmëri të tillë. Ky shpjegim do të jepet në gjuhën e ndërfaqes *online* që klienti fillimisht kërkoi të përdorte.

Neni 6
Aksesi në mallra ose shërbime

1. Palët sigurojnë që tregtarëve t'u ndalohet të zbatojnë kushte të përgjithshme të ndryshme të aksesit në mallra ose shërbime për arsye që lidhen me palën, ku klienti është person fizik, ose mbi bazën e vendbanimit ose vendit të themelimit të klientit në një palë, ku klienti kërkon të:

a) blejë mallra nga një tregtar dhe ato mallra ose të dorëzohen në një vendndodhje në një palë ku tregtari ofron dorëzimin në kushtet e përgjithshme të aksesit, ose ato mallra të mblidhen në një vendndodhje të rënë dakord nga tregtari dhe klienti në një palë në të cilën tregtari i ofron një mundësi të tillë në kushtet e përgjithshme të aksesit;

b) marrë shërbime të ofruara në mënyrë elektronike nga tregtari, përveç shërbimeve, karakteristika kryesore e të cilave është sigurimi i aksesit dhe përdorimi i veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit ose çështje të tjera të mbrojtura, përfshirë shitjen e veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit ose çështjeve të mbrojtura në një formë jomateriale;

c) marrë shërbime nga një tregtar, përveç shërbimeve të ofruara në mënyrë elektronike, në vendndodhjen fizike brenda palës ku tregtari operon.

2. Palët sigurojnë që ndalimet sipas paragrafit 1 nuk i pengojnë tregtarët të ofrojnë kushte të përgjithshme aksesi, duke përfshirë çmimet neto të shitjes, të cilat ndryshojnë midis palëve ose brenda një pale dhe që u ofrohen klientëve në një territor të caktuar ose grupeve të veçanta të klientëve mbi bazë jodiskriminuese.

3. Palët angazhohen të sigurojnë në mënyrë të qartë që pajtueshmëria me ndalimet sipas paragrafit 1 nuk nënkupton, në vetvete, se një tregtar është i detyruar të përmbushë kërkesat ligjore jokontraktuale në një palë të caktuar, në lidhje me mallrat dhe shërbimet përkatëse të palës së klientit ose të informojë klientët për këto kërkesa.

4. Palët sigurojnë që ndalimet sipas paragrafit 1, pika "b" nuk do të zbatohen për tregtarët që përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)

sipas ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të palës, ndaj të cilave u nënshtrohen aktivitetet e tregtarit.

5. Palët angazhohen të marrin parasysh që ndalimet sipas paragrafit 1 nuk zbatohen në masën që një dispozitë specifike e përcaktuar në ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të një pale dhe në përputhje me CEFTA-n, si dhe me çdo vendim të marrë bazuar në të, ndaj të cilave u nënshtrohen aktivitetet e tregtarit, e ndalon tregtarin të shesë mallrat ose t'u ofrojë shërbime klientëve të caktuar ose klientëve në territore të caktuara.

6. Palët angazhohen të marrin parasysh se në lidhje me shitjen e mallrave, ndalimet sipas paragrafit 1 nuk pengojnë tregtarët të vendosin çmime të ndryshme për klientët në tregje të caktuara gjeografike në masën që u kërkohet ta bëjnë këtë sipas ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të një pale dhe në përputhje me CEFTA-n, si dhe me të gjitha marrëveshjet në kuadër të saj.

Neni 7

Mos-diskriminimi për arsye të lidhura me pagesën

1. Palët sigurojnë që tregtarët të ndalohen të aplikojnë, brenda gamës së mjeteve të pagesës të pranuara nga tregtari, për arsye të lidhura me palën ku klienti është person fizik, ose mbi bazën e vendbanimit ose vendit të themelimit të klientit në një palë, vendndodhjes së llogarisë së pagesës, vendit të themelimit të ofruesit të shërbimit të pagesave ose vendit të emetimit të instrumentit të pagesës në një palë, kushte të ndryshme për një transaksion pagese, ku:

a) transaksioni i pagesës realizohet përmes një transaksioni elektronik me transfertë krediti, debitim direkt ose një instrument pagese të bazuar në kartë brenda të njëjtës mënyrë dhe kategori pagese;

b) kërkesat e autentifikimit sipas kërkesave të ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të palës së cilës i nënshtrohet veprimtaria e tregtarit, duke përfshirë marrëveshjet përkatëse me palët e tjera; dhe

c) transaksionet e pagesave janë në monedhën që tregtari e pranon.

2. Palët angazhohen të marrin parasysh se kur justifikohet nga arsye objektive, ndalimi sipas paragrafit 1 nuk pengon tregtarin të ndalojë dorëzimin e mallrave ose ofrimin e shërbimit, derisa tregtari të ketë marrë konfirmimin se transaksioni i pagesës është kryer siç duhet.

3. Palët garantojnë që ndalimi sipas paragrafit 1 nuk pengon tregtarin të kërkojë tarifa për përdorimin e një instrumenti pagese të bazuar në kartë, për të cilin tarifat e këmbimit nuk janë të rregulluara sipas ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të palës ndaj së cilës i nënshtrohet veprimtaria e tregtarit dhe për aq kohë sa ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të palës e lejojnë tregtarin të kërkojë tarifa të tilla. Tarifat e disponueshme për një kërkesë të tillë nuk duhet të kalojnë kostot e drejtpërdrejta të mbuluara nga tregtari për përdorimin e instrumentit të pagesës.

4. Palët garantojnë që ndalimi sipas paragrafit 1 nuk zbatohet për situatat kur transaksioni i pagesës nuk mund të kryhet për shkak të mungesës së mundësive teknike, mungesës së ndërveprimit ndërmjet sistemeve të pagesave ose ndonjë arsye tjetër objektive teknike ose teknologjike që i atribuohet sistemeve të veçanta të pagesave, shërbimeve të pagesave ose instrumenteve të pagesave.

Neni 8

Zbatimi

Secila nga palët merr përsipër:

a) të caktojë një organ ose organe përgjegjëse për zbatimin e përshtatshëm dhe efektiv të këtij vendimi;

b) të përcaktojë rregullat që vendosin masa efektive, proporcionale dhe frenuese, të zbatueshme për shkeljet e këtij vendimi dhe të garantojë zbatimin e tyre.

Neni 9

Ndihma për konsumatorët

1. Secila nga palët merr përsipër të caktojë një organ ose organe përgjegjëse për ofrimin e ndihmës praktike për konsumatorët në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje ndërmjet një konsumatori dhe një tregtari, që lind nga vendimi.

2. Ofrimi i ndihmës praktike sipas kuptimit të paragrafit 1 interpretohet si kryerja e aktiviteteve nga një organ ose organe përkatëse të caktuara brenda kompetencave dhe funksioneve të tyre tashmë ekzistuese dhe të vendosura në përputhje me ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të palës.

Neni 10
Komunikimi dhe bashkëpunimi ndërpalësh

1. Secila nga palët merr përsipër:

a) t'i komunikojë Nënkomitetit për Tregtinë në Shërbime masat e miratuara për zbatimin e këtij vendimi;

b) të bashkëpunojë me palët e tjera përmes Pikës së Kontaktit për Shërbimet dhe në mënyrë të ngjashme, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi. Më specifikisht, palët përpiqen që sa më shpejt të jetë e mundur dhe në përputhje me ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të palës, të ofrojnë ndihmën dhe informacionin e kërkuar nga palët e tjera, duke përfshirë mjetet e duhura elektronike;

c) Secila palë siguron përgjigje të menjëhershme nëpërmjet Pikës së Kontaktit për Shërbimet ndaj të gjitha kërkesave nga një palë tjetër për informacione specifike mbi çdo masë të saj të zbatimit të përgjithshëm në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, duke përfshirë aspektet që lidhen me këtë vendim;

d) të nxisë komunikimin me Nënkomitetin për Tregtinë në Shërbime, për çdo vendim të rëndësishëm administrativ ose gjyqësor të marrë brenda një pale, në lidhje me mosmarrëveshjet mbi këtë vendim.

2. Palët sigurojnë burimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

KAPITULLI III
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 11
Hyrja në fuqi

Vendimi do të hyjë në fuqi dy vjet pas miratimit të tij.

Miratuar në Beograd, më 9 tetor 2024, në prani të përfaqësuesve të të gjitha palëve të CEFTA-s.

VENDIM
Nr. 839, datë 5.11.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 221, DATË 28.3.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK PËR ETIKETIMIN E PRODUKTEVE TË QELQIT KRISTAL"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 221, datë 28.3.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik për etiketimin e produkteve të qelqit kristal", bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 5, fjalët "... ose një përshkrim që shkakton konfuzion ..." zëvendësohen me "... ose një përshkrim që mund të ngatërrohet me të ...".

2. Në pikën 6, pas fjalës "... teknik ..." shtohen fjalët "... mund të ...".

3. Pas pikës 7 shtohet pika 8, me këtë përmbajtje:

"8. Parashikimet e këtij rregulli teknik nuk zbatohen për produktet e destinuara për eksport drejt vendeve, të cilat nuk janë pjesë e Bashkimit Evropian.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

[1] *Ky vendim synon përafimin plotësisht me direktivën e Këshillit 69/493/EEC, datë 15 dhjetor 1969, mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare, në lidhje me qelqin kristal; nr. celex: 31969L0493; OJ L 326, 29.12.1969, p. 36.*

VENDIM
Nr. 840, datë 5.11.2026

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË KOMPENSIMIT PËR SHOQËRITË E LINJAVE TË TRANSPORTIT QYTETËS, RRETHQYTETËS DHE NDËRQYTETËS NË KUSHTET E SITUATËS SË VEÇANTË NË TREGUN HIDROKARBUR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, të ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

Kompensimin e shoqërive të transportit për linjat qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse, në masën 50 (pesëdhjetë) lekë për litër karburanti, për një periudhë pesëmujore, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor 2026. Kompensimi bëhet për shumën e konsumimit të karburantit gjatë periudhës së kompensimit, por jo më shumë se 110% e sasisë mesatare mujore të karburantit të konsumuar gjatë periudhës mars–maj 2026, për secilën nga shoqëritë.

II. KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PËRFITIMIN E KOMPENSIMIT

1. Kërkesa për të përfituar kompensimin financiar, të përcaktuar në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, bëhet nga subjekti vetëm një herë, pas përfundimit të periudhës së kompensimit, pranë administratës tatimore, nën juridiksionin e së cilës ai është regjistruar, e cila bën verifikimin e dokumentacionit të paraqitur.

2. Subjektet kërkuese duhet të paraqesin pranë administratës tatimore, nën juridiksionin e së cilës janë regjistruar, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Kopjen e licencës përkatëse, të vlefshme për transportin qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës;

c) Të dhënat identifikuese të subjektit tatimpagues të pajisur me NIUS;

ç) Emrin e bankës, ku subjekti përfitues ka llogarinë rrjedhëse bankare;

d) IBAN-in e llogarisë bankare (jo më shumë se 28) karaktere dhe në monedhën lekë;

dh) Për shoqëritë që kryejnë vetëm aktivitet të transportit qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës, kopje të faturave fizike të furnizimit me karburant, për periudhat mars–maj 2026 dhe qershor–tetor 2026;

e) Për shoqëritë, që, përveç aktivitetit të transportit qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës, ushtrojnë edhe aktivitete të tjera, përveç kopjeve të faturave fizike të furnizimit me karburant, për periudhat mars–maj 2026 dhe qershor–tetor 2026, duhet të paraqesin edhe:

i. vetëdeklarim të sasisë së karburantit të përdorur për transportin qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës, shoqëruar me fatura të blerjes;

ii. kopje të fletëdaljeve të karburantit gjatë periudhave mars–maj 2026 dhe qershor–tetor 2026, të përdorur për transportin qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës, sipas targave të mjeteve.

3. Kërkesat nga subjektet paraqiten pas datës 10 (dhjetë) të muajit pasardhës, duke filluar nga muaji nëntor 2026.

4. Në rastin kur konstatohet se dokumentet e dorëzuara nga subjekti janë të paplota apo kanë mangësi, administrata tatimore, brenda 5 (pesë) ditëve punë, e kthen kërkesën, me qëllim plotësimin e dokumentacionit.

5. Administrata tatimore, pas verifikimit të dokumentacionit, të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, dërgon pranë degës përkatëse të thesarit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve punë, urdhër-shpenzimet, duke bashkëlidhur listën përmbledhëse të subjekteve përfituese, sipas bankave të nivelit të dytë, ku përfituesit kanë llogarinë e tyre bankare.

6. Për shoqëritë që nuk kanë ushtruar aktivitet gjatë gjithë periudhës mars–maj 2026, si vlerë reference për kompensim merret sasia mesatare mujore e karburantit të konsumuar, që shërben si bazë referuese për përllogaritjen e kompensimit, përcaktohet duke pjesëtuar sasinë totale të karburantit të konsumuar dhe të dokumentuar gjatë muajve të plotë të ushtrimit të aktivitetit, brenda kësaj periudhe, me numrin e këtyre muajve.

Përllogaritja kryhet mbi bazën e dokumentacionit provues të paraqitur nga subjekti dhe të verifikuar nga administrata detare.

7. Me qëllim shmangien e abuzimit, strukturat e administratës tatimore mund të kryejnë edhe verifikime në vend, në rast konstatimi të pasaktësive në dokumentacionin e paraqitur në kërkesë.

8. Struktura e thesarit në degë, mbas marrjes së urdhërshpenzimit me listën e përfituesve, sipas pikës 5, të këtij kreu, kryen pagesën brenda 5 (pesë) ditëve punë.

III. ÇËSHTJE TË FUNDIT

1. Kërkesat për kompensim do të pranohen deri në datën 16 nëntor 2026.

2. Efektet financiare, prej 209 022 872 (dyqind e nëntë milionë e njëzet e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh, do të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, të miratuar për vitin 2026.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

KËRKESË

EMRI I SUBJEKTIT: _____
NIPT-i: _____
Banka: _____ (vetëm për bankat aktive)

Iban (LEK)_____ (jo më shumë se 28 karaktere)

*Bashkëlidhur kësaj kërkese:
- kopja e licencës aktive;
- vërtetimi i lëshuar nga banka për llogarinë bankare;
- kopje të faturave fizike të furnizimit me karburant për periudhat: qershor, korrik, gusht, shtator 2026.

VENDIM
Nr. 841, datë 5.11.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 278, DATË 29.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI 'SISTEMIM RRUGËSH, BLLOKU 'PËRROI I ÇAPRAZIT', POGRADEC'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 278, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti 'Sistemim rrugësh, blloku 'Përroi i Çapraziť, Pogradec"', bëhen këto ndryshime:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera "... 23 003 616 (njëzet e tre milionë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh ..." zëvendësohet me "... 27 514 746 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind e katërmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e gjashtë) lekësh ...";

b) Të dhënat për shpronësim të numrit rendor 7 të tabelës, bashkëlidhur vendimit nr. 278, datë 29.4.2022, zëvendësohen me të dhënat me të njëjtin numër rendor të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Bashkisë Pogradec.

3. Bashkëpronarët e pasurisë të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në numrin rendor 7 të tabelës, bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur

dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

4. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e bashkëpronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, Bashkia Pogradec dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI "SISTEMIM RRUGËSH BLLOKU 'PËRROI I ÇAPRAZIT", POGRADEC"

Nr.	Emër Mbiemër			Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Shënime
7	Vasil	Kostaq	Marko	8582	14/146	Truall	m²	627	10,491	6,577,857	
	Petro	Kostaq	Marko								
	Kristaq	Kostaq	Marko								
	Violentina	Jorgji	Bixheku								
	Marie	Jorgji	Nasho								
	Vlash	Jorgji	Tiri								
	Eliverta	Naum	Marko								
	Valentina	Naum	Cici								
	Ilias	Skender	Marko								
	Migela	Skender	Xhani(Marko)								
	Artan	Skender	Marko								
	Bardhyl	Naum	Marko								
	Aleksandra	Naum	Marko								
	Roza	Naum	Marko								
	Vladimir	Naum	Marko								
	Kaliopi	Naum	Marko								
	Liliana	Vasil	Marko								
	Denada	Vergjil	Marko								
	Ervin	Vergjil	Marko								
	Shuma totale e shpronësimit									**6,577,857.00**	

Efekti financiar shtesë është 4,511,130 lekë

VENDIM
Nr. 842, datë 5.11.2026

PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË STRUKTURAVE AKOMODUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 43/1, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim përcakton kategoritë e strukturave akomoduese, sipas tipologjisë, funksionit, mënyrës së organizimit dhe karakteristikave të shërbimit të akomodimit, si dhe kriteret e projektimit e të ndërtimit për projektet e integruara të kategorisë. Këto kritere verifikohen edhe gjatë procedurës së kategorizimit paraprak, sipas legjislacionit në fuqi për turizmin.

2. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "**Certifikatë paraprake kategorizimi**", dokumenti i lëshuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, përpara miratimit të lejes së ndërtimit për strukturën akomoduese, i cili përcakton kategorinë e propozuar dhe vërteton përputhshmërinë e projektit me kriteret e kategorisë përkatëse, pa zëvendësuar lejen e ndërtimit ose aktet e tjera të kërkuara nga legjislacioni në fuqi;

b) "**Apart-hotel**", struktura akomoduese e përbërë nga apartamente të destinuara për akomodim turistik, të cilat mund të jenë në pronësi

individuale dhe ofrojnë shërbime të përbashkëta në funksion të turizmit, nën të njëjtin administrim e menaxhim, me recepsion ose pritje të përbashkët;

c) "**Resort miks**", zhvillimi i integruar, i paraqitur për certifikim paraprak, që përfshin një strukturë akomoduese të kategorisë "resort", njësi me funksion rezidencial, si dhe ambiente, shërbime dhe infrastrukturë të përbashkët në funksion të zhvillimit;

ç) "**Komponent turistik**", tërësia e sipërfaqeve të ndërtimit të strukturës akomoduese të kategorisë "resort" dhe e sipërfaqeve të tjera të destinuara ekskluzivisht për funksione dhe shërbime turistike;

d) "**Komponent rezidencial**", tërësia e sipërfaqeve të ndërtimit të objekteve, të njësive ose të pjesëve të objekteve të destinuara për funksion rezidencial;

dh) "**Sipërfaqe totale e ndërtimit**", shuma e sipërfaqeve të ndërtimit, që rezultojnë nga dokumentacioni teknik i projektit për komponentin përkatës, të llogaritura sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;

e) "**Pjesë e objektit**", pjesa funksionalisht e dallueshme e një objekti me përdorim të përzier, sipërfaqja e së cilës, në bazë të dokumentacionit teknik të projektit dhe përdorimit të dokumentuar, i ngarkohet komponentit turistik ose komponentit rezidencial, sipas rastit, në përputhje me dokumentacionin e miratuar sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

3. Strukturat akomoduese kategorizohen, si më poshtë vijon:

a) "Bujtinë" (shtëpi pritëse);

b) "Fjetinë" (*hostel*);

c) "Kamping";

ç) "Hotel";

d) "Motel";

dh) "Resort";

e) "Qendër kurative";

ë) "Fjetje dhe mëngjes" (*Bed&B*);

f) "Apart-hotel";

g) "Strukturë akomoduese e trashëgimisë kulturore";

gj) "Resort miks", si nënkategori e kategorisë "resort", vetëm për qëllime të certifikimit paraprak të zhvillimit të integruar.

4. Për kategoritë e parashikuara në pikën 3 të këtij vendimi, termat e përkufizuar në ligjin nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, kanë kuptimin e dhënë në këtë ligj. Për kategoritë dhe termat e përkufizuar në pikën 2 të këtij vendimi zbatohen përkufizimet e kësaj pike.

5. Apartamentet, vilat e dhomat brenda zhvillimit "resort miks" trajtohen sipas destinacionit të përcaktuar në dokumentacionin e miratuar të projektit. Kur janë të destinuara për akomodim turistik, ato përfshihen në komponentin turistik dhe në strukturën e kategorisë "resort", nën administrimin e përbashkët të saj, pa u kategorizuar veçmas. Kur janë të destinuara për funksion rezidencial, për ndryshimin e destinacionit ose përdorimit të tyre, zbatohen pikat 17 e 18 të këtij vendimi.

6. Në projektet e reja, apartamentet, vilat e dhomat, që parashikohen për akomodim turistik, nuk kategorizohen si struktura të veçanta. Ato përfshihen në komponentin turistik të një strukture të kategorisë "resort", përfshirë zhvillimin "resort miks", dhe mbulohen nga certifikata e saj. Njësitë e projektuara si banesa, jashtë një strukture të tillë, nuk mund të ofrohen si akomodim turistik pa u përfshirë në një projekt që plotëson kërkesat e kategorisë "resort", sipas legjislacionit në fuqi.

7. Hoteli i shpërndarë mund të organizohet brenda kategorisë "resort", përfshirë komponentin turistik të zhvillimit "resort miks", kur plotëson njëkohësisht përkufizimin e hotelit të shpërndarë dhe përkufizimin e resortit, sipas pikave 61 e 28, të nenit 4, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar. Njësitë e tij ndodhen në ndërtesa ekzistuese, afër njëra-tjetrës, nën menaxhimin e të njëjtit sipërmarrës turistik, dhe përfshihen në organizimin e administrimin e përbashkët të resortit. Kategorizimi kryhet për resortin në tërësi. Emërtimi "hotel i shpërndarë" nuk zëvendëson plotësimin e kërkesave të kategorisë "resort". Për strukturat e certifikuara më parë zbatohen përcaktimet e pikës 21 të këtij vendimi.

8. Çdo subjekt zhvillues, përpara miratimit të lejes së ndërtimit për strukturë akomoduese nga organi përgjegjës, pajiset me certifikatë paraprake kategorizimi, në përputhje me pikën 1/1, të nenit 43/1, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar. Kushtet, kriteret, afatet e procedura e kategorizimit, përfshirë kategorizimin paraprak, përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin, sipas pikës 6, të nenit 43/1, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar.

9. Për projektin e kategorisë "resort miks", komponenti turistik dhe komponenti rezidencial

përcaktohen, identifikohen e paraqiten në mënyrë të dallueshme në dokumentacionin e projektit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

10. Në zhvillimin e kategorisë "resort miks", sipërfaqja totale e ndërtimit e komponentit turistik duhet të jetë jo më e vogël se 60 (gjashtëdhjetë) për qind e shumës së sipërfaqeve totale të ndërtimit të komponentit turistik dhe të komponentit rezidencial. Sipërfaqja totale e ndërtimit e komponentit rezidencial nuk duhet të jetë më e madhe se 40 (dyzet) për qind e kësaj shume.

11. Për llogaritjen e raportit të përcaktuar në pikën 10 të këtij vendimi:

a) në komponentin turistik përfshihen sipërfaqet totale të ndërtimit të strukturës akomoduese të kategorisë "resort" dhe sipërfaqet e tjera të destinuara ekskluzivisht për funksione dhe shërbime turistike;

b) në komponentin rezidencial përfshihen sipërfaqet totale të ndërtimit të objekteve, të njësive ose të pjesëve të objekteve të destinuara për funksion rezidencial;

c) sipërfaqet e ambienteve, shërbimeve dhe infrastrukturës së përbashkët, që u shërbejnë njëkohësisht komponentit turistik dhe komponentit rezidencial dhe nuk mund të ndahen objektivisht sipas përdorimit, u shpërndahen të dy komponentëve në përpjesëtim me sipërfaqet e identifikuara drejtpërdrejt për secilin komponent;

ç) sipërfaqet që, pavarësisht emërtimit në projekt, i shërbejnë kryesisht njërit komponent ose përdorimi i të cilave mund të ndahet në mënyrë objektive, i ngarkohen komponentit përkatës ose ndahen ndërmjet komponentëve në përpjesëtim me përdorimin e dokumentuar. Asnjë sipërfaqe ndërtimi e zhvillimit nuk përjashtohet nga llogaritja e raportit.

12. Dokumentacioni i projektit "resort miks" përmban tabelën e sipërfaqeve për çdo objekt, kat e funksion, identifikimin e sipërfaqeve të komponentit turistik, të komponentit rezidencial dhe të sipërfaqeve të përbashkëta, mënyrën e shpërndarjes së këtyre të fundit, si dhe përllogaritjen e raportit, sipas pikave 10 e 11 të këtij vendimi. Tabela dhe përllogaritja nënshkruhen nga projektuesi përgjegjës dhe nga subjekti zhvillues.

13. Raporti i përcaktuar në pikën 10 të këtij vendimi llogaritet vetëm mbi sipërfaqen totale të ndërtimit.

14. Përcaktimet e pikave 9–13 të këtij vendimi zbatohen pa cenuar përdorimin e lejuar të tokës, intensitetin e ndërtimit, koeficientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim, lartësinë, distancat dhe treguesit e tjerë të zhvillimit, të përcaktuar në dokumentet e planifikimit apo në rregulloret e veçanta të miratuara nga KKTU-ja.

15. Certifikata paraprake e kategorizimit vlerëson përputhshmërinë e projektit me kategorinë turistike të propozuar. Ajo nuk krijon të drejtë ndërtimi, nuk zëvendëson lejen e ndërtimit dhe nuk kufizon kompetencat e autoritetit përgjegjës për zhvillimin e territorit.

16. Çdo ndryshim i projektit, i aplikuar pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, përpara ose gjatë ndërtimit të strukturës, që prek kategorinë e propozuar, ndarjen funksionale të komponentëve ose raportin e përcaktuar në pikën 10 të këtij vendimi, u nënshtrohet paraprakisht ndryshimit të certifikatës paraprake të kategorizimit dhe, sipas rastit, procedurave për ndryshimin e lejes së ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi.

17. Pas përfundimit të ndërtimit të zhvillimit "resort miks", procedurës së kategorizimit dhe të klasifikimit si strukturë akomoduese i nënshtrohet vetëm komponenti turistik i kategorisë "resort", duke përfshirë apartamentet, vilat dhe dhomat e destinuara për akomodim turistik, si dhe hotelin e shpërndarë, të organizuar sipas pikës 7 të këtij vendimi. Njësitë e komponentit rezidencial nuk kategorizohen e nuk klasifikohen si pjesë e strukturës akomoduese, përveçse kur përdoren për akomodim turistik dhe plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi për turizmin.

18. Ndryshimi i destinacionit ose i përdorimit të njësive të komponentit rezidencial për qëllime akomodimi turistik kryhet vetëm pas përmbushjes së kërkesave të legjislacionit për turizmin dhe të legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Pas miratimit të ndryshimit, njësitë përfshihen në komponentin turistik dhe në administrimin e strukturës së kategorisë "resort", pa u kategorizuar veçmas si "akomodim turistik në banesa", dhe ndryshimi reflektohet në dokumentacionin e projektit dhe në përllogaritjen e raportit sipas pikave 10 e 11 të këtij vendimi.

19. Për strukturat akomoduese, për të cilat është lëshuar dokumenti i lejes së ndërtimit nga autoriteti kompetent përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 83/2026, nuk kërkohet certifikatë paraprake

kategorizimi. Këto struktura u nënshtrohen kategorizimit dhe, kur zbatohet, klasifikimit, sipas legjislacionit në fuqi për turizmin, përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë.

20. Strukturat akomoduese, për të cilat nuk është lëshuar ende dokumenti i lejes së ndërtimit nga autoriteti përgjegjës përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 83/2026, i nënshtrohen kategorizimit për marrjen e certifikatës paraprake.

21. Certifikatat e kategorizimit të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, përfshirë certifikatat për kategoritë "apartament", "vilë", "dhomë", "bllok apartamentesh" dhe "hotel i shpërndarë" ruajnë vlefshmërinë e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për turizmin. Njësitë e akomodimit turistik të pajisura me këto certifikata vijojnë ushtrimin e veprimtarisë sipas kategorisë së certifikuar, duke përmbushur detyrimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për ushtrimin e veprimtarisë së akomodimit turistik.

22. Kërkesat e reja për kategorizim shqyrtohen sipas kategorive të përcaktuara në këtë vendim. Kur projekti parashikon apartamente, vila, dhoma ose bllok apartamentesh për akomodim turistik, ato identifikohen në komponentin turistik të strukturës së kategorisë "resort", përfshirë "resort miks", dhe nuk kategorizohen veçmas. Kushtet, kriteret, afatet e procedurat e kategorizimit përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin, në zbatim të pikës 6, të nenit 43/1, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar.

23. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 843, datë 5.11.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 730, DATË 13.12.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DEKLARIMIN PASURI KULTURORE E PALUAJTSHME E ZONAVE ARKEOLOGJIKE 'A' DHE 'B' TË QYTETIT TË SARANDËS, 'KALASË SË LËKURËSIT' E 'MANASTIRIT TË 40 SHENJTORËVE' DHE MIRATIMIN E ZONIMIT E TË PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjave "a" e "ç", të pikës 3, të nenit 9, dhe të nënndarjes "iv", të shkronjës "b", pikës 3, të nenit 53, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 730, datë 13.12.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme e zonave arkeologjike 'A' dhe 'B' të qytetit të Sarandës, 'Kalasë së Lëkurësit' e 'Manastirit të 40 Shenjtorëve' dhe miratimin e zonimit e të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Harta e zonimit dhe koordinatat përkatëse të zonës arkeologjike "B" të qytetit të Sarandës, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me hartën e zonimit dhe koordinatat përkatëse në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

b) Koordinatat përkatëse të zonës arkeologjike "A" të qytetit të Sarandës, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me koordinatat përkatëse në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.


2. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kadastrën.

3. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartën e zonës arkeologjike "B" të qytetit të Sarandës në Gjeoportalin Kombëtar.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Sarandë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Zona Arkeologjike "A", Sarandë		
Nr.	N	E
1	4415430.5	500338.2886
2	4415652.808	500359.0252
3	4415708.76	500361.11
4	4415752.52	500538.16
5	4415674.174	500583.865
6	4415594.01	500603.7
7	4415521.7	500632.64
8	4415494.64	500639.45
9	4415485.96	500629.09
10	4415472.15	500595.75
11	4415417.29	500415.78
12	4415407.45	500406.8
13	4415396.81	500360.13
14	4415400.36	500332.88

Zona Arkeologjike "B", Sarandë		
Nr.	X	Y
1	501095.051	4415421.823
2	501042.32	4415427.448
3	501022.047	4415437.008
4	500999.43	4415440.549
5	500979.354	4415447.127
6	500937.171	4415445.097
7	500913.537	4415450.663
8	500812.654	4415435.971
9	500692.458	4415406.851
10	500652.816	4415401.785
11	500529.825	4415356.215
12	500400.734	4415318.746
13	500309.759	4415287.355
14	500263.509	4415287.353
15	500240.13	4415279.252
16	500222.849	4415278.239
17	500213.701	4415287.858
18	500205.06	4415313.675
19	500204.042	4415355.693
20	500182.188	4415355.186
21	500145.467	4415349.11
22	500138.352	4415363.791
23	500092.991	4415399.353
24	500048.265	4415425.424
25	500035.305	4415432.511
26	500008.623	4415465.522
27	500008.47	4415487.05
28	500008.65	4415499.55
29	500047.67	4415511.31
30	500077.77	4415528.67
31	500102.13	4415547.48
32	500128.54	4415565.73
33	500135.54	4415580.1
34	500143.75	4415601.15
35	500141.23	4415636.43
36	500151.13	4415660.27
37	500164.29	4415674.74
38	500191.85	4415699.05
39	500189.75	4415712.26
40	500189.84	4415730.55
41	500205.62	4415732.6
42	500222.28	4415736.15
43	500235.34	4415746.04
44	500253.17	4415752.58
45	500258.63	4415813.2
46	500350.24	4415807.83
47	500501.2	4415869.55
48	500519.5	4415885.69
49	500544.65	4415870.9
50	500626.88	4415824.93
51	500629.96	4415814.34
52	500635.73	4415757.7
53	500690.89	4415749.56
54	500736.01	4415740.11
55	500848.62	4415687.28
56	500971.14	4415623.89
57	500994.99	4415605.22
58	501048.4	4415538.03
59	501082.79	4415506.81
60	501113.97	4415489.78
61	501151.67	4415470.6
62	501143.46	4415446.89
63	501174.31	4415427.43
64	501169.45	4415389.02
65	501174.68	4415315.59
66	501160.87	4415307.28
67	501122.41	4415372.19

VENDIM
Nr. 844, datë 5.11.2026

PËR MIRATIMIN E MASËS SË MBËSHTETJES FINANCIARE PËR KUJDESIN ALTERNATIV NË FAMILJE, SI DHE TË PAGESËS PËR KUJDESIN ALTERNATIV PROFESIONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 31, të ligjit nr. 92/2025, "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbështetja financiare për familjen kujdestare dhe për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje, përfshin:

a) mbështetje financiare mujore për çdo fëmijë të vendosur në kujdes alternativ në familje për përmbushjen e nevojave të jetesës së përditshme të fëmijës, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj;

b) mbështetje financiare vjetore për çdo fëmijë të vendosur në kujdes alternativ në familje, për përballimin e shpenzimeve të tjera sipas nevojave, në masën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në vit;

c) mbështetje financiare mujore për familjen që ofron kujdes alternativ profesional, të njëjtë dhe të barasvlershme me nivelin e pagës minimale të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Mbështetja financiare mujore e përcaktuar në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij vendimi, jepet një herë në muaj, pavarësisht numrit të fëmijëve në kujdes alternativ, për aq kohë sa familja kujdestare profesionale është e regjistruar si ofruese e shërbimit dhe ka në kujdes alternativ në familje të paktën një fëmijë, sipas vendimit përkatës, me përjashtim të familjeve kujdestare profesionale të emergjencës, të cilat e përfitojnë pagesën sipas pikës 7, të këtij vendimi.

3. Prindi aplikues i familjes kujdestare profesionale punësohet për ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ në familje pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ka vendbanimin e përhershëm dhe lidh kontratë pune me këtë njësi.

4. Marrëdhëniet e punës ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe prindit aplikues të familjes kujdestare profesionale rregullohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

5. Me marrjen e vendimit gjyqësor për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje, përfitimi i mbështetjes financiare, sipas pikës 1, të këtij vendimi, fillon pas lidhjes së kontratës së punës ndërmjet prindit aplikues të familjes kujdestare profesionale dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mbështetja financiare ndërpritet me përfundimin e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje.

6. Pagesa mujore përfitohet edhe në rastet kur prindi aplikues është i punësuar, i vetëpunësuar ose ushtron një veprimtari tjetër profesionale. Në çdo rast, prindi duhet të sigurojë organizimin e kohës dhe të veprimtarisë në mënyrë të tillë që të mos cenohen në asnjë rast nevojat, siguria, mirëqenia dhe interesi më i lartë i fëmijës.

7. Në rastin e familjeve kujdestare profesionale të emergjencës, përfitimi i pagesës fillon në momentin e lidhjes së kontratës së punës ndërmjet prindit aplikues të familjes kujdestare profesionale të emergjencës me njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe ndërpritet me përfundimin e marrëdhënies së punës/humbjen e statusit të familjes kujdestare profesionale të emergjencës, sipas legjislacionit në fuqi.

8. Njësitë e vetëqeverisjes vendore informojnë Shërbimin Social Shtetëror, nëpërmjet strukturave rajonale të varësisë, për fillimin dhe përfundimin e ofrimit të shërbimit nga familjet kujdestare profesionale dhe fëmijët e vendosur në kujdes alternativ, që përfitojnë mbështetje financiare sipas këtij vendimi.

9. Mbështetja financiare e parashikuar në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të këtij vendimi, indeksohet çdo vit në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit, nga Shërbimi Social Shtetëror.

10. Fondet për mbështetjen financiare për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje mbulohen nga buxheti i shtetit, të cilat u transferohen njësive të vetëqeverisjes vendore.

11. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 845, datë 5.11.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 78, DATË 7.2.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MASËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFITIMIT TË NJË PAKETE TË VEÇANTË HIGJIENO-SANITARE, PËR INVALIDËT PARAPLEGJIKË DHE TETRAPLEGJIKË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 78, datë 7.2.2007, të Këshillit të Ministrave, fjalët "... 20 480 (njëzet mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë në muaj ..." zëvendësohen me "... 21 074 (njëzet e një mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë në muaj ...".

2. Ngarkohen Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2027.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 846, datë 5.11.2026

PËR RISHPËRNDARJEN E FONDEVE NDËRMJET PROGRAMEVE BUXHETORE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL, NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2026

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2026, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin "Mbështetje për peshkimin", tavani buxhetor i shpenzimeve korrente pakësohet në vlerën prej 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milionë) lekësh;

b) Në programin "Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit", tavani buxhetor i shpenzimeve korrente shtohet në vlerën prej 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 847, datë 5.11.2026

PËR KUSHTET E TJERA DHE PROCEDURAT PËR MIRATIMIN E TRUPAVE TË KONTROLLIT DHE NJOFTIMIN E AKTIVITETIT NGA TRUPAT E KONTROLLIT, QË VEPROJNË NË SHQIPËRI SIPAS STANDARDEVE TË TJERA PËR PRODHIMIN ORGANIK[2]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 45, të ligjit nr. 104/2024, "Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

[2] Ky vendim është përafruar pjesërisht me rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (BE) nr. 2018/848, të datës 30 maj 2018, "Mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike dhe shfuqizimin e rregullores së Këshillit (KE) nr. 834/2007". Numri CELEX: 32018R0848, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, 150, datë 14.6.2018, faqe 1–92.

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë kushtet e tjera, përveç atyre të përcaktuara në pikën 3, të nenit 45, të ligjit nr. 104/2024, "Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre" (në vijim, ligji), procedurat për miratimin e trupave të kontrollit që veprojnë sipas ligjit dhe njoftimin e aktivitetit nga trupat e kontrollit që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, sipas standardeve të tjera për prodhimin organik.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky vendim zbatohet, për:

a) trupat e kontrollit, që kërkojnë miratim, ndryshim të fushës së miratimit ose rinovim të miratimit, për të vepruar sipas ligjit, për certifikimin e operatorëve ose grupit të operatorëve organikë në Republikën e Shqipërisë;

b) trupat e kontrollit, që kërkojnë njoftimin e aktivitetit, për të vepruar sipas standardeve të tjera për prodhimin organik, për certifikimin e operatorit ose grupit të operatorëve organikë, të njohura për të vepruar në Republikën e Shqipërisë nga autoritetet kompetente të vendeve përkatëse ose nga Komisioni Evropian, kur veprojnë sipas standardit evropian.

2. Ky vendim përcakton:

a) kushtet e tjera për miratimin, ndryshimin e fushës së miratimit dhe rinovimin e miratimit të trupave të kontrollit, që veprojnë sipas ligjit;

b) procedurat për miratimin, ndryshimin e fushës së miratimit dhe rinovimin e miratimit të trupave të kontrollit, që veprojnë sipas ligjit;

c) procedurat për njoftimin e aktivitetit të trupave të kontrollit, që veprojnë sipas standardeve të tjera për prodhimin organik, të njohura nga autoritetet kompetente të vendeve përkatëse, ose nga Komisioni Evropian, kur veprojnë sipas standardit evropian për të vepruar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Përkufizime

Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e përcaktuara në nenin 3 të ligjit.

Neni 4
Trupat e kontrollit, që veprojnë sipas ligjit dhe standardeve të tjera

Trupa e kontrollit, e cila kërkon të ushtrojë veprimtarinë e saj në Republikën e Shqipërisë, njëkohësisht sipas ligjit dhe standardeve të tjera për prodhimin organik, duhet të ndjekë procedura të ndara, duke paraqitur aplikime të veçanta për miratim dhe njoftim, në përputhje me nenet 7–12, të këtij vendimi.

Neni 5
Publikimi i listës së trupave të kontrollit

Ministria përgjegjëse për bujqësinë publikon e përditëson në faqen zyrtare:

a) listën e trupave të kontrollit të miratuara për fushën e ligjit, me të dhënat përkatëse, lidhur me emrat, adresat, adresat e faqes zyrtare, kodin, fushën dhe kategoritë e produkteve të miratuara dhe afatin e vlefshmërisë së miratimit;

b) listën me të dhënat lidhur me emrat, adresat e faqes zyrtare, kodin, kategoritë e produkteve dhe të dhëna të tjera të mundshme për trupat e kontrollit, që veprojnë në Republikën e Shqipërisë sipas standardit evropian ose standardeve të tjera dhe që kanë njoftuar aktivitetin në ministri.

Publikimi dhe përditësimi kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga miratimi ose njoftimi i aktivitetit të tyre.

Neni 6
Kushtet e tjera për miratimin, ndryshimin e fushës së miratimit dhe rinovimin e miratimit të trupave të kontrollit, që veprojnë sipas fushës së ligjit

Trupa e kontrollit, që kërkon miratim, ndryshim të fushës së miratimit ose rinovim të miratimit, për certifikimin e operatorit ose të grupit të operatorëve organikë, sipas ligjit, përveç kushteve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 45, të ligjit, dhe në legjislacionin

në fuqi për kontrollin zyrtar, plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Ka një zyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të pajisur me mjetet e përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë dhe me personel të përhershëm. Personeli, që kryen veprimtarinë e inspektimit, komunikon në gjuhën shqipe dhe gjithë dokumentacioni, që lidhet me procesin e inspektimit e të certifikimit të operatorit ose grupit të operatorit organik sipas fushës së ligjit, hartohet, plotësohet, mbahet dhe raportohet në gjuhën shqipe;

b) Zotëron ekspertizën, pajisjet dhe infrastrukturën e duhur për të kryer detyrat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prodhimin organik;

c) Ka personel të mjaftueshëm, me kualifikime, kompetencë dhe përvojën profesionale të duhur për të kryer detyrat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prodhimin organik;

ç) Është e paanshme dhe nuk ka konflikt interesi për të ushtruar detyrat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prodhimin organik;

d) Ka organizimin e duhur të brendshëm për të kryer detyrat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 45, të ligjit, me detyra e përgjegjësi të ndara të inspektorit dhe certifikuesit, për të siguruar paanshmëri dhe shmangie të konfliktit të interesit;

dh) Ka në zbatim procedura, që sigurojnë koordinim efikas dhe efektiv, ndërmjet saj dhe ministrisë, autoriteteve kompetente të kontrollit zyrtar dhe trupave të tjera të kontrollit;

e) Ka paguar tarifën, në përputhje me pikën 11, të nenit 45, të ligjit.

Neni 7

Procedura e miratimit të trupave të kontrollit, që veprojnë sipas ligjit dhe ankimimi

1. Aplikimi për miratimin e trupës së kontrollit, siç përcaktohet në pikën 2, të nenit 45, të ligjit, kryhet *online* në portalin qeveritar "*e-Albania*".

2. Aplikimi sipas pikës 1, të këtij neni, shoqërohet me:

a) dokumentacionin për procedurën e vlerësimit të riskut, që përcakton bazën për intensitetin dhe shpeshtësinë e verifikimit të përputhshmërisë së operatorit dhe grupit të operatorëve;

b) dokumentacionin për procedurën standarde të kontrollit dhe certifikimit, që përmban një përshkrim të detajuar të masave të kontrollit dhe vendimit të certifikimit, që ndërmerr trupa e kontrollit ndaj operatorit e grupit të operatorëve nën kontrollin e saj;

c) dokumentacionin që përshkruan masat, të cilat merren në përputhje me katalogun e përbashkët të masave, të përcaktuar në pikën 3, të nenit 51, të ligjit, për operatorin e grupin e operatorëve, në rastet e mospërputhjeve të dyshuara ose të vërtetuara;

ç) dokumentacionin për procedurën e monitorimit efektiv të detyrave të caktuara për inspektimin, certifikimin dhe aktivitete të tjera të kontrollit zyrtar, që kryen trupa e kontrollit në lidhje me operatorin e grupin e operatorëve dhe raportimin për kryerjen e tyre;

d) certifikatën e vlefshme të akreditimit dhe raportin e fundit të akreditimit për fushën e ligjit, në përputhje me standardet e harmonizuara për akreditimin;

dh) kontratat me laboratorë të akreditуar për analizimin e mostrave dhe dokumentacionin për procedurat standarde të marrjes së mostrave;

e) dokumentacionin për strukturën organizative të punonjësve, kualifikimet profesionale e përvojën e tyre;

ë) procedurat e brendshme dhe deklaratat e personelit për të siguruar në çdo rast paanshmëri dhe shmangie të konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrave të personelit;

f) tarifat që aplikohen për inspektimin dhe certifikimin e operatorit ose grupit të operatorëve dhe metodologjinë e llogaritjes së këtyre tarifave;

g) dokumentacionin për procedurat e brendshme të komunikimit me ministrinë, autoritetet kompetente të kontrollit zyrtar dhe trupat e tjera të kontrollit;

gj) adresa dhe të dhënat e kontaktit të zyrës lokale, ku ushtron veprimtarinë trupa e kontrollit, si dhe të drejtuesit të saj, së bashku me dokumentacionin që vërteton se zyra disponon kapacitetet, mjetet e burimet njerëzore të nevojshme për ushtrimin efektiv të veprimtarisë;

h) mandatin e pagesës së tarifës, sipas pikës 11, të nenit 45, të ligjit.

3. Aplikimi i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, pranohet nga sektori përgjegjës për prodhimin organik në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, i cili shërben si sekretariat teknik i komisionit për prodhimin organik (KPO) dhe verifikon paraprakisht plotësimin e aplikimit dhe të

dokumentacionit shoqërues të kërkuar, brenda 5 (pesë) ditëve punë. Në rast të mangësive të vërejtura në plotësimin e formularit të aplikimit ose dokumentacionit shoqërues, sektori njofton vetëm një herë aplikantin për plotësimin e mangësive brenda afatit 7 (shtatë) ditë pune, nëpërmjet portalit "*e-Albania*". Në rast se aplikanti nuk plotëson mangësitë brenda afatit, aplikimi i përcillet KPO-së për vijimin e procedurave për vlerësimin e aplikimit.

4. Kur aplikimi është plotësuar në përputhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni, sekretariati teknik ia paraqet për shqyrtim KPO-së dosjen e plotë të aplikimit.

5. KPO-ja mblidhet e shqyrton aplikimin për miratim të trupës së kontrollit brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga depozitimi i aplikimit nga sekretariati teknik.

6. Në rast se aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në ligj dhe këtë vendim, KPO-ja i propozon ministrit miratimin e trupës së kontrollit dhe pajisjen me certifikatë regjistrimi brenda 5 (pesë) ditëve punë. Në këtë rast, sekretariati kryen menjëherë njoftimin për miratimin e aplikimit nëpërmjet portalit qeveritar "*e-Albania*", në të cilin ngarkohet urdhri i ministrit dhe certifikata e regjistrimit.

7. Afati i vlefshmërisë së certifikatës së regjistrimit, sipas pikës 6, të këtij neni, është 5 (pesë) vjet nga data e miratimit nga ministri, me të drejtë rinovimi për aq kohë sa trupa e kontrollit vazhdon të përmbushë kushtet e miratimit dhe të ruajë vlefshmërinë e akreditimit.

8. Kur aplikimi nuk plotëson tërësisht kërkesat e përcaktuara në ligj dhe në këtë vendim, KPO-ja i propozon ministrit refuzimin e aplikimit dhe sekretariati njofton menjëherë për vendimin e arsyet e refuzimit, nëpërmjet portalit qeveritar "*e-Albania*", në të cilin ngarkohet urdhri i ministrit.

9. Kundër vendimit për refuzimin e kërkesës, aplikuesi ka të drejtën e ankimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 8

Ndryshimi i fushës së miratimit të trupës së kontrollit, që vepron sipas ligjit

1. Aplikimi për ndryshimin e fushës së miratimit të trupës së kontrollit kryhet *online* në portalin qeveritar "*e-Albania*".

2. Aplikimi i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, përmban kërkesën për zgjerim ose reduktim të fushës së miratimit, për sa i përket fushës së veprimtarisë për certifikim të operatorit ose grupit të operatorëve organikë dhe kategorisë së produkteve, të përcaktuara në pikën 7, të nenit 37, të ligjit.

3. Në rast të ndryshimit të fushës së akreditimit, trupa e kontrollit aplikon menjëherë për ndryshim të fushës së miratimit.

4. Në rast të kërkesës për zgjerim të fushës së miratimit, aplikimi konsiderohet si aplikim i ri për miratim dhe zbatohet procedura sipas nenit 7, të këtij vendimi.

5. Në rast të miratimit të kërkesës për zgjerim, afati i vlefshmërisë së certifikatës së regjistrimit është 5 (pesë) vjet nga data e miratimit nga ministri të aplikimit për zgjerim të fushës së miratimit, me të drejtë rinovimi.

6. Kur aplikimi për zgjerim të fushës së miratimit nuk miratohet, certifikata e mëparshme e miratimit mbetet e pandryshuar, për sa i përket fushës së miratimit dhe afatit të vlefshmërisë.

7. Në rast të kërkesës për reduktim të fushës së miratimit, aplikimi nuk shoqërohet me dokumentacion, por vetëm me një përshkrim të arsyes së kërkesës.

8. KPO-ja vlerëson aplikimin brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga depozitimi i aplikimit nga sekretariati teknik dhe i propozon ministrit miratimin e reduktimit të fushës së miratimit të trupës së kontrollit dhe pajisjen me certifikatë regjistrimi brenda 5 (pesë) ditëve punë. Në këtë rast, sekretariati njofton menjëherë për miratimin e aplikimit, nëpërmjet portalit qeveritar "*e-Albania*", në të cilin ngarkohet urdhri i ministrit dhe certifikata e re e regjistrimit. Certifikata e re e regjistrimit përmban fushën aktuale të miratimit të veprimtarisë, për certifikim të operatorit ose grupit të operatorëve organikë dhe kategoritë aktuale të produkteve dhe zëvendëson certifikatën e mëparshme të miratimit të trupës së kontrollit.

9. Afati i vlefshmërisë së certifikatës së regjistrimit të përcaktuar në pikën 8, të këtij neni, mbetet i pandryshuar nga miratimi fillestar.

Neni 9

Rinovimi i miratimit të trupës së kontrollit, që vepron sipas ligjit

1. Aplikimi për rinovimin e miratimit paraqitet nga trupa e kontrollit 3 (tre) muaj përpara

përfundimit të vlefshmërisë së miratimit, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 7, të këtij vendimi.

2. Trupa e kontrollit, së cilës i ka kaluar afati i vlefshmërisë së miratimit, nuk duhet të kryejë aktivitet sipas ligjit.

3. Vlerësimi i aplikimit për rinovim bazohet edhe në rezultatet e mbikëqyrjes së aktivitetit të trupës së kontrollit, të kryer të paktën një herë në vit, në përputhje me nenin 47, të ligjit.

Neni 10

Certifikata dhe kodi i regjistrimit të trupës së kontrollit

1. Certifikata e regjistrimit të trupës së kontrollit lëshohet sipas formatit në aneksin I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, dhe përmban:

a) kodin unik identifikues të trupës së kontrollit;

b) fushën e veprimtarisë dhe kategoritë e produkteve, për të cilat miratohet trupa e kontrollit, sipas përcaktimit në pikën 7, të nenit 37, të ligjit;

c) datën e fillimit e të përfundimit të vlefshmërisë së certifikatës.

2. Pas miratimit, trupës së kontrollit i caktohet një kod identifikimi, i cili është unik për çdo trupë kontrolli dhe duhet:

a) të fillojë me akronimin ALB, që identifikon Shqipërinë;

b) të përmbajë termin "BIO", i cili tregon metodën e prodhimit organik;

c) të përmbajë një numër identifikues progresiv, që përcaktohet nga komisioni për prodhimin organik, i cili përmban 3 shifra, duke filluar nga numri 001.

Neni 11

Detyrimet e tjera të trupës së kontrollit, që vepron sipas ligjit

1. Trupa e kontrollit të miratuar sipas këtij vendimi, përveç detyrimit për paraqitjen e informacioneve sipas nenit 50, të ligjit, plotëson edhe detyrimet e përcaktuara në këtë nen.

2. Në rast të shfuqizimit të miratimit, sipas nenit 49, të ligjit, trupa e kontrollit informon operatorët në sistemin e vet të kontrollit, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit për shfuqizimin e miratimit, në mënyrë që operatorët të zgjedhin dhe të transferojnë dosjen e kontrollit tek një trupë tjetër kontrolli, brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

3. Në rast të ndërprerjes së aktivitetit nga vetë trupa e kontrollit, ajo njofton menjëherë ministrinë përgjegjëse për bujqësinë në lidhje me arsyet dhe afatin e parashikuar të ndërprerjes, si dhe njofton operatorët në sistemin e saj të kontrollit, në mënyrë që të zgjedhin një trupë tjetër kontrolli.

4. Informacioni në lidhje me shfuqizimin e miratimit të trupës së kontrollit, sipas nenit 49, të ligjit, ose ndërprerjen e aktivitetit, sipas pikës 4, të këtij neni, përditësohet e publikohet sipas nenit 5, të këtij vendimi.

Neni 12

Procedura e njoftimit të aktivitetit nga trupat e kontrollit që veprojnë sipas standardeve të tjera për prodhimin organik

1. Aplikimi për njoftimin e aktivitetit nga trupa e kontrollit që vepron në Republikën e Shqipërisë, sipas standardeve të tjera për prodhimin organik, siç përcaktohet në pikën 2, të nenit 45, të ligjit, kryhet *online* në portalin qeveritar "*e-Albania*".

2. Aplikimi për njoftimin e aktivitetit të trupës së kontrollit shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm, i cili paraqitet në shqip ose në gjuhë të huaj (i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar):

a) Kontratën dhe të dhënat e personit të kontaktit për komunikimin me ministrinë dhe autoritetet kompetente për kontrollin zyrtar, si dhe:

i. kopje të certifikatës së regjistrimit në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë, nëse trupa e kontrollit është e regjistruar në Republikën e Shqipërisë;

ii. të dhënat e zyrës lokale në Shqipëri, nëse trupa e kontrollit ka një zyrë të tillë;

b) Kopjen e certifikatës së akreditimit bashkë me programin e akreditimit, në të cilin duhet të përfshihet aktiviteti i trupës së kontrollit në Republikën e Shqipërisë dhe raporti i fundit nga organi akreditues;

c) Dokumentin e njohjes nga Komisioni Evropian për të vepruar në Republikën e Shqipërisë, kur vepron sipas standardit evropian;

ç) Dokumentin e njohjes nga autoriteti kompetent përkatës, për të vepruar në Shqipëri, kur vepron sipas një standardi tjetër nga ai evropian;

d) Raportin e fundit të auditimit nga Komisioni Evropian, kur trupa e kontrollit vepron sipas

standardit evropian, dhe/ose raportin e fundit të auditimit nga autoriteti kompetent përkatës, kur trupa e kontrollit vepron sipas një standardi tjetër, nëse raporti përkatës është i disponueshëm;

dh) Listën e operatorëve në sistemin e tyre të kontrollit në momentin e paraqitjes së kërkesës, nëse ka;

e) Llojin e aktivitetit dhe kategoritë e produkteve, që janë objekt i sistemit të tyre të kontrollit dhe certifikimit;

ë) Dokumentin e pagesës së tarifës, në përputhje me pikën 11, të nenit 45, të ligjit.

3. Aplikimi pranohet nga sektori përgjegjës për prodhimin organik në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, i cili verifikon paraprakisht plotësimin e aplikimit për njoftim të aktivitetit dhe dokumentacionin e kërkuar, brenda 5 (pesë) ditëve punë. Në rast të mangësive të vërejtura në plotësimin e formularit të aplikimit ose të dokumentacionit shoqërues, sektori njofton vetëm një herë aplikantin për plotësimin e mangësive, brenda afatit 7 (shtatë) ditë pune, nëpërmjet portalit "*e-Albania*". Në rast se aplikanti nuk plotëson mangësitë brenda afatit, aplikimi i përcillet KPO-së për vijimin e procedurave.

4. Kur aplikimi është plotësuar në përputhje me pikat 1 e 2, të këtij neni, sekretariati teknik ia paraqet KPO-së dosjen e plotë të aplikimit për shqyrtim.

5. KPO-ja, brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga depozitimi i aplikimit nga sekretariati teknik, mblidhet e shqyrton aplikimin për njoftim.

6. Në rast se aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në ligj dhe në këtë vendim, KPO-ja i propozon ministrit miratimin e njoftimit të trupës së kontrollit.

7. Kur aplikimi nuk plotëson tërësisht kërkesat e përcaktuara në këtë vendim, KPO-ja i propozon ministrit refuzimin e aplikimit të njoftimit. Në këtë rast, sekretariati njofton menjëherë për refuzimin e aplikimit për njoftim, nëpërmjet portalit qeveritar "*e-Albania*", në të cilin ngarkohet urdhri i ministrit.

8. Kundër vendimit për refuzimin e kërkesës, aplikuesi ka të drejtën e ankimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve punë nga marrja e njoftimit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

9. Në rast të ndërprerjes së aktivitetit në Republikën e Shqipërisë nga vetë trupa e kontrollit ose heqjes së njohjes ose pezullimit të pjesshëm ose të plotë nga Komisioni Evropian ose autoriteti përkatës për standardet e tjera, ajo njofton menjëherë ministrinë përgjegjëse për bujqësinë në lidhje me arsyet dhe afatin e parashikuar të ndërprerjes, si dhe njofton operatorët në sistemin e saj të kontrollit, në mënyrë që të zgjedhin një trupë tjetër kontrolli.

Neni 13

Detyrimet e trupës së kontrollit që vepron sipas standardeve të tjera, që ka njoftuar aktivitetin

1. Trupa e kontrollit që ka njoftuar aktivitetin sipas nenit 12, të këtij vendimi, njofton menjëherë ministrinë përgjegjëse për bujqësinë për të gjitha ndryshimet në fushën e veprimtarisë për certifikim të operatorit ose grupit të operatorëve organikë në Republikën e Shqipërisë dhe kategoritë e produkteve, të përcaktuara në pikën 7, të nenit 37, të ligjit.

2. Trupa e kontrollit që ka njoftuar aktivitetin, sipas nenit 12, të këtij vendimi, informon ministrinë përgjegjëse për bujqësinë lidhur me:

a) mospërputhshmëritë, që cenojnë integritetin e produkteve organike, menjëherë sapo konstatohen tek operatorët në sistemin e saj të kontrollit;

b) listën e operatorëve organikë që prodhojnë në Republikën e Shqipërisë, në sistemin e saj të kontrollit, brenda datës 31 janar të çdo viti, për vitin paraardhës;

c) të gjithë informacionin statistikor në lidhje me operatorët ose grupin e operatorëve organikë që prodhojnë në Republikën e Shqipërisë, nën kontrollin e saj, brenda datës 1 mars të çdo viti dhe sa herë i kërkohet nga ministria ose autoritetet kompetente të kontrollit zyrtar.

3. Në rast të refuzimit të aplikimit sipas pikës 7, të nenit 12, të këtij vendimi, dhe kur trupa e kontrollit nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, ministria njofton menjëherë operatorët në sistemin e saj të kontrollit dhe Komisionin Evropian, kur vepron sipas standardit evropian, ose autoritetet kompetente përkatëse, nëse vepron sipas standardeve të tjera.

Neni 14

Shfuqizime

1. Vendimi nr. 639, datë 14.5.2008, i Këshillit të Ministrave, "Për strukturën, funksionimin dhe

përcaktimin e kritereve të pranimit e të vlerësimit të dokumentacionit të nevojshëm e të detyrimeve të organizmave certifikues", dhe neni 12, i vendimit nr. 830, datë 18.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të hollësishme për grumbullimin, ambalazhimin, transportin, ruajtjen, etiketimin, njoftimin e aktivitetit dhe kontrollin e produkteve biologjike", shfuqizohen.

2. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian shfuqizohen nenet 5, 6 dhe 10, të këtij vendimi.

Neni 15
Institucionet që ngarkohen

Ngarkohen ministria përgjegjëse për bujqësinë, institucioni përgjegjës për inspektimin dhe kontrollin zyrtar të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë, struktura përgjegjëse për inspektimin dhe kontrollin zyrtar të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve dhe trupat e kontrollit për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 16
Dispozita kalimtare

1. Trupat e kontrollit që veprojnë sipas fushës së ligjit, të cilave u ka përfunduar vlefshmëria e miratimit, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 104/2024, "Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre", paraqesin kërkesën për rinovimin e miratimit, në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Shërbimet elektronike të parashikuara në këtë vendim fillojnë të zbatohen pas realizimit dhe vënies në funksion të zhvillimeve teknike të nevojshme në portalin qeveritar "*e-Albania*".

3. Deri në momentin e vënies në funksion të zhvillimeve teknike, sipas pikës 2, të këtij neni, aplikimet vijojnë në formë shkresore.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI I
MODELI I CERTIFIKATËS SË REGJISTRIMIT TË TRUPAVE TË KONTROLLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

CERTIFIKATË REGJISTRIMI

Nr. _____ prot. **Datë _____._____.202__**

_____

(Emri i trupës së kontrollit)

Kodi i trupës së kontrollit

ALB. BIO. 001_

Komisioni për prodhimin organik (KPO), bazuar në vendimin nr.___, datë __.__.2026, të Këshillit të Ministrave, "Për kushtet e tjera dhe procedurat për miratimin e trupave të kontrollit dhe njoftimin e aktivitetit nga trupat e kontrollit, që veprojnë në Shqipëri sipas standardeve të tjera për prodhimin organik", në mbledhjen e datës __.__.____, vendosi të miratojë regjistrimin e _____, si trupë kontrolli për inspektimin dhe certifikimin e operatorëve ose të grupit të operatorëve organik/ë, sipas fushës së ligjit nr.104/2024, "Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre", për aktivitetet e mëposhtme:

- Prodhim;
- Përgatitje;
- Shpërndarje/vendosje në treg;
- Magazinim, ruajtje;
- Import;
- Eksport

për kategoritë e produkteve, sipas pikës 7, të nenit 37, të ligjit:

- bimë dhe produkte me origjinë bimore të papërpunuara, përfshirë farat e materiale të tjera mbjellëse dhe shumëzuese bimore;
- kafshët dhe produktet shtazore të papërpunuara;
- algat dhe produktet e papërpunuara nga akuakultura;
- produktet bujqësore të përpunuara, përfshirë produktet nga akuakultura, të cilat përdoren si ushqim;
- ushqimet për kafshë;
- vera;
- produkte të tjera të përcaktuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ose që nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme.

Data e regjistrimit: __.__.____.

Regjistrimi është i vlefshëm deri më __.__.____.

Bazuar në certifikatën e akreditimit me numër regjistri _____, me periudhë vlefshmërie akreditimi nga data __.__.____ deri më __.__.____, trupa e kontrollit regjistrohet për fushat e mësipërme.

Vlefshmëria e kësaj certifikate humbet, në rast se trupa e kontrollit nuk paraqet certifikatën e rinovuar të akreditimit, pranë ministrisë, brenda 1 (një) muaji nga përfundimi i periudhës së vlefshmërisë së saj.

PËR
KOMISIONIN E PRODHIMIT ORGANIK

K R Y E T A R I

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr. 102 (61-2026-3159), datë 20.7.2026, vendosi plotësimin e vendimit nr. 293, datë 23.6.2026, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, në pikë 2 të dispozitivit të shtohet togëfjalëshi: "Në Vlorë, Shqipëri më datë 3.7.2017.".

Ky vendim i bashkëngjitet vendimit nr. 293, datë 23.6.2026, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2026 - Numri: 241
Datë: 09.11.2026 13:32:24 +01:00
c15ba35c-cf1e-437f-bb26-98dd296de066
Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)